

BIBLIOTEKA  
SHTETIT

81H-32

K 95



Kandidatja  
e fundit  
TREGIME

FADIL KRAJA

811-32

K95

FADIL KRAJA

# KANDIDATJA E FUNDIT

*Tregime*



1695

SHTËPIA BOTUESE «NAIM FRASHËRI»

## NJË NGJARJE E THJESHTË

Pas tetë orësh udhëtimi, aty nga mesnata arrita më së fundi në Fierzë. Bëra një gomë në Çibik që më kushtoi një orë lodhje, prita po aq kohë të shkëmbi i Miliskaut derisa punëtorët e rrugores të hapnin rrugën, që ishte bllokuar nga një shembje. Rruga ishte e re, gjithkund malore dhe për më tepër binte një borë e imtë, që era e përplaste në xhamet e «Skodës», duke më vështirësuar pamjen. Stekat pastruese nuk e kryenin dot detyrën e tyre, ndaj detyroheshja të ndalja maqinën dhe herë pas here dilja të pastroja xhamet. Kisha me vete një kuzhinier plak nga Tirana, që shkonte vullnetar për një vit në veprën e madhe.

Isha i ngarkuar me 50 kuintal oriz. Parku ynë kishte marrë përsipër të mbushte me ushqim të gjitha magazinat e Fierzës. Dimër i thonë, dimri është i pabesë dhe t'i blokon rrugët për javë të tëra ndër këto bjeshkë të larta. Që punëtorët të kishin ushqim të bollshëm, ne, shoferët, udhëtonim ditë e natë, për një muaj të tërë.

Kur arrita më së fundi, zbrita kuzhinierin të klubi dhe maqinën e çova te magazina. E dija se do të më shkarkonin menjëherë. Atij që ka qenë në Fierzë,

gjëja e parë që i bie në sy, është se aty nuk ka orar. Kur e do puna, edhe nëpunësit e administratës kthehen në punëtorë shkarkimi.

Kur pashë se filloi shkarkimi, i lashë policngarkesën magazinierit, një djaloshi vendës, tepër energjik dhe shkova në mensë. Ishte e mbyllur, po nuk u dëshpërova. Në Fierzë është një klub që rri hapur natë e ditë për ne, shoferët. Përveç pijeve, gjen diçka edhe për të ngrënë, konserva, djathë. Megjithatë, nuk pata nevojë të haja gjëra të thata. Pasagjeri im nga Tirana po më priste me një dopio pilaf që avullonte dhe me një thelë të madhe mishi përsipër. M'u bë qejfi që ky plak i mirë ishte kujtuar për mua. Sa gjë e madhe është kur të rrethon respekti dhe mirësia në kantieret e largëta! Harron lodhjen dhe të mbushet zemra me mendime fisnike.

Mora dy gota verë dhe po hanim të kënaqur me kuzhinierin plak, kur hyri në klub magazinieri. Kujtova se po më sillte policngarkesën e firmosur, ndaj e ftova të ulej në tryezë. Po ai qëndronte në këmbë dhe fërkonte duart me sëlëndi, me turp.

— Si e ke hallin, buçko? — e pyeta.

M'u përgjegj duke i zvarritur fjalët:

— Shoku shofer... unë... i numërova thasët...

— Bukur fort, të dolën 100 thasë?

— Puna është se ... jo 100... dolën 99.

— Gabim, buçko. Janë 100. Shko i numëro edhe një herë — thashë i sigurt, sepse në stacionin hekurudhor të Laçit i kishim numëruar mirë.

Magazinieri përsëri fërkoi duart me turp.

— I numërova tri herë... pastaj i numëroi dhe shefi i llogarisë, që po ndihmonte në shkarkim, edhe inxhinier Feriti, edhe doktori. Dolën 99.

M'u pre oreksi. Kuzhinieri e pikasi tronditjen time dhe foli:

— Ti, shoku magazinier, shko! Ne do të vijmë pas pak.

— Jo — ndërhyra. — Prit, se po vij tani!

— Pastaj, pasi të hamë darkën. Shko ti, shok!  
— nguli këmbë tiranasi.

— Mirë — tha magazinieri — dhe më falni që erdha kështu... nuk e dija... ju e kuptoni... jam magazinier... pastaj i ri...

— Shko, shko. Do të rregullohet puna! — qe përgjegjja e kuzhinierit.

Dhe, kur ai mbylli portën pas nesh, kuzhinieri tha:

— Darkën do ta përfundojmë se s'bën. Asgjë nuk fiton, po të mos hash. Hajde, biri im, ha dhe pi me zor. Po e pate zemrën e mirë dhe ndërgjegjen e pastër, thesi me oriz do të gjendet — foli dhe më rrahu supin miqësisht.

— Po këtu nuk është punë zemre dhe ndërgjegjeje — thashë unë. — Gjithë kjo rrugë e gjatë... ndalesat...

— Dyshon se ta ka vjedhur njeri?

— Nuk mund të mendoj ashtu!

— Të ketë rënë rrugës?

— Ndoshta.

— Atëhere do ta gjej ndonjë shofer dhe do ta sjellë. Sidoqoftë mos u mërzit. Ha tani, se u ftoh mishi!

Nuk e di si arrita t'i bindesha kuzhinierit dhe ta çoja deri në fund atë darkë të vështirë. Nuk ishte puna te 400 lekët, që do të paguaja për 50 kilogram oriz, se sa te turpi. Nuk doja të mendonin keq për mua, as magazinieri, as shokët e ndërmarrjes, as

kuzhinieri. Nuk më kishte ngjarë kurrë të dilja mangut në ngarkesë, në të dhjetë vjetët e profesionit tim si shofer.

Kuzhinieri më shoqëroi te magazina, ku tani po shkarkonin sheqer. Ishte «Skoda» e Markut, shokut të brigadës. Ai sapo kishte arritur. Më lindi një fill shprese. Ndoshta Marku e ka gjetur thesin në rrugë.

— Jo! — më tha. — Tj e di se dritat i kam të forta dhe rruga është e ngushtë. Patjetër do ta kisha parë. Mos të ka rënë në hone?

— Hone? Po, gjithë rruga është me hone!

Kjo do të thoshte se duhej të mos shpresoja më.

Shefi i llogarisë, inxhinieri, mjeku, kuzhinieri dhe Marku, më ndihmuan të stivoja thasët, dhjetë e dhjetë. E bëmë punën ngadalë, me sytë katër. Megjithatë stiva e fundit mbetej me 9 thasë.

Ika në klub nga turpi. Ika me vrap. Bora më përplasej në fytyrë, errësira më pengonte ecjen. U rrëzova disa herë, po gjithnjë ngrihesha, bile doja që rruga për në klub të mos kishte fund dhe unë të ecja, të ecja i shoqëruar nga mendimet e mia të rënda, të ecja dhe të mos shikoja asnjëri. I qullur u ula te banaku. Banakieri, që e kishte marrë vesh ngjarjen, nuk më bëri zë, por shkoi te ekspresi dhe më bëri një kafe. Ma zgjati në heshtje.

— Pije të nxehtë! Të bën mirë. Pije nga unë! — tha.

Fjalët e fundit më ranë si shuplakë. M'u duk se më mëshironte banakieri Nikë. Më dukej se edhe kuzhinieri, edhe shefi i llogarisë, edhe mjeku, edhe inxhinieri, edhe shoku im, Marku, më mëshironin. Desha t'u thosha se nuk kisha nevojë as për kafënë, as për...

Dora e kuzhinierit më preku në sup:

— Qenke i ngutshëm, biri im, nuk bën kështu!  
Nuk kemi ardhur këtu për të të mëshiruar, por si shokë, si vëllezër. Gjëra të tilla u ngjasin shoferëve.

— Sa herë ka ndodhur kjo! Mua vetë më ka ndodhur dy herë vjet — gënjeu Marku.

— Pse gënjen? — i thashë. — Po, edhe sikur të të ketë ngjarë ty, pse të më ngjasë edhe mua?

— Ndoshta mund të bëhet një procesverbal dhe...

E shikova rreptë shefin e llogarisë që foli ashtu.  
Kujtonte ai se vuaja për lekët!

Ndërhyri mjeku:

— Sidoqoftë, ora është dy pas mesnate. Ti duhet të flesh, shoku shofer! Ne flemë edhe ditën, kurse ti do të udhëtosh përsëri.

Të gjithë qenë të një mendimi me mjekun. Vetëm unë jo.

— Shkon! — u thashë. — Nuk kam gjumë. Do të rri edhe pak në klub, pastaj do të fle. Në maqinë kam shtratin tim.

Siç duket kuzhinieri i bindi që të më linin vetëm. Ata më uruan natë të mirë dhe shkuan.

— Më mbush një gotë raki! — i thashë Nikës.

— Mirë — m'u përgjegj. — Por ama pije ngadalë! Po kërkove për të dytën herë, nuk të jap.

— Do të më japësh se s'bën! Atë punë ke ti.

— Ta dish se nuk të jap! Pije ngadalë, po deshe të mos zihemi bashkë.

E piva ngadalë, por ajo e shkretë një gotë ishte. E zgjata një orë me pak meze djathi dhe mbaroi. Iu luta Nikës si fëmija. Nuk u zbut.

— Po të të bëj një kafe tjetër. Po deshe çaj... Kemi edhe salep të ngrohtë valë. Këto pije t'i jap, tjetër mos kërk.

— Së paku një konjak!

Më solli kafe. U detyrova të bindesha. Kështu më kaloi ajo pjesë e natës, duke sjellë ndër mend të gjithë rrugën që kisha bërë, që nga Laçi e deri këtu. Asgjë nuk më bënte të dyshoja, se ma kishin vjedhur orizin. U binda se më kishte rënë në hon. Borë binte, erë frynte, motorri, i sforcuar në të përpjetë, bënte zhurmë. Nuk do ta kisha dëgjuar...

Në të zbardhur të ditës, klubi filloi të mbushej me punëtorët e turnit. Kafetë dhe fërneta venin e vinin në banak. Nika nuk kishte kohë të merrej me mua. Biseda dhe shaka në klub. Fytyra të qeshura punëtorësh, peliçe blu, kafe, bojë mjaltë, ndonjë qeleshe malësori tek-tuk.

M'ua afrua një malësor i parruar, rreth të pesëdhjetave.

— Ti je ai shoferi që solli orizin mbëmë?

Solla kokën i lodhur dhe iu përgjegja pa qejf.

— Unë jam, e pastaj? Nuk kam vend dhe nuk udhëtoj sot.

Malësori qeshi.

— Ngadalë, bre burrë, mos e merr me grysh. Prit një herë dhe pyet si e kam hallin, pastaj folë.

— Kam hallet e mia sot.

— Jo, he burrë, se sot hallet qahen së bashku.

U ul në karrige dhe drodhi një cigare. Më shikoi gjatë, pastaj më zgjati dorën e vrazhdë dhe më tundi supin.

— Or mik, orizin ta solla. E ke në magazinë.

M'u bë se nuk e dëgjova mirë. M'u bë se po dremisja dhe po shikoja në ëndërr...

— Cilin oriz solle? — e pyeta.

— Thesin, de, që të kishte rënë rrugës. E gjeta në përrua. Kisha dalë të ngrija kurth për shqarr në pyll, kur pashë thesin. Mendova se do t'i kishte rënë



ndonjë shoferi. E mora në shpinë dhe e solla këtu.

E shikoja dhe nuk u besoja syve.

— Ku e gjete? Si e solle? Kur e solle! — e mbyta me pyetje.

Aj qeshi pa të keq.

— Ngadalë, se më mbyte! Në Flet e gjeta. Në shpinë e solla. Tash sa e solla. Desha të nisem fill, se kam punë në shtëpi, por ai magazinieri më shtrëngoi të të lajmëroja. Nuk donte të të lajmëronte vetë. «Shko ti!» më tha. Dhe erdha.

E shikoja malësorin e mirë dhe sikur nuk u besoja veshëve. Nga Fletin në Fierzë bëhen 3 orë në këmbë. Ai malësor kishte udhëtuar gjithë natën për të ma sjellë thesin e gjetur. Kjo ishte një mrekulli. Nuk dija si ta falënderoja. Çfarë t'i thosha? Banakieri bënte kafetë te ekspresi dhe qeshte. I kishte dëgjuar sa tha malësori. Qeshte i mallëkuari, sigurisht me mua.

— Solle orizin dhe nuk deshe të takoheshe me mua? — i thashë në vend të falënderimit, që më dukej shumë i vogël dhe, për këtë gjë, nuk e nxirrja dot.

— E pse të takohesha? Nuk ishte gjë e madhe. Orizi ishte i shtetit.

— Pi një kafe me mua — thashë i gëzuar dhe i prekur nga fjalët e malësorit.

— Po bre, si nuk po e pimë një kafe? Na i piqdy, o Nikë! Një me pak sheqer!

Pimë kafetë në heshtje dhe u drejtua të dy të paguanim. Nika foli:

— Mos u lodhni. Për kafe të tilla nuk ka banakier, që i bën zemra të marrë lekë. I keni prej meje! — dhe qeshi përsëri.

U nisëm të dilnim. Në portë ndesha me kuzhinierin tiranas. U mata t'i tregoja.

— E di — më tha. — Më treguan. Le që ti kuptohesh në fytyrë. Po pse të bën përshtypje? Kjo është një ngjarje e thjeshtë. Të thashë mbrëmë! Ti qenke i ngutshëm, biri im. Nuk i njohke fort mirë njerëzit tanë.

## KUNDËR RRYMES

Selimi po ngjitej ngadalë Gurit të Kuq, atij masivi që shkëputej nga pylli i shkozës dhe binte thikë mbi lumin e rrëmbyer të Drinit. Guri kishte një ngjyrë kafe të çelët dhe në pjerrësinë e tij, të lëmuar nga erërat dhe shiu, plaku kishte gjetur një vend të përshtatshëm për të tharë sherbelën, që e mblidhte kur dhitë kullosnin shpatit të pyllit. Megjithëse mesi i korrikut, në pyll ishte freskët. Kur doli në majë të shkëmbit, rrezet e diellit i ranë në fytyrë dhe bulëzat e djersës i buluan në ballin plot me rrudha. Sherbela ishte tharë më së miri dhe aroma e saj dehëse i ngacmoi hundën. Tek po e mblidhte në thes, plaku teshtiti. Pasi e mblodhi të gjithë sherbelën, nxori një leckë dhe filloi të fshinte shkëmbin që ta kishte gati për të nesërmen për të shtrirë aty gjethet e reja. Padashur i vajtën sytë poshtë në lumë dhe mbeti i habitur. Poshtë, në zallin e lumit, mbi një shkëmb që kushedi si ishte ndarë nga mali, shtrihej pa teklif një vajzë. Po, po, një femër me rroba banjoje, që plakun e bëri të dridhej nga sikleti. Këmbët i kishte lëshuar deri poshtë që t'ia përkëdhelnin valët, ndërsa kokën e kishte mbështetur mbi dy duart e kryqëzuara. Nuk e dallonte dot se cila

ishte, po cila do që të qe, si kishte guxuar të luante mendsh dhe të shkelte deri në atë dërrasë turpi në fshatin e tij?

Plaku ofshani thellë, hodhi thesin e sherbelës në shpinë dhe, para se të zbriste, shikoi edhe një herë nga vajza. Kjo e fundit, si për inat të tij, u ngrit në këmbë, lëkundti një herë krahët sa para prapa dhe u hodh në lumë. E përpinë valët. Plaku e humbi nga sytë dhe u tremb.

— U mbyt shejtanja! I qenka rënduar jeta dhe u mbyt. Po cila të ishte, bre? Tani dëshira për të arritur bregun iu shtua. Ndoshta e gjente trupin e saj, ose së paku rrobet ose...

Vrapoi tatëpjetë shtegut duke gulçuar.

Lumi i Drinit bënte papritmas një kthesë të fortë, i shtrënguar nga një brinjë mali. Në atë kthesë, valët, pasi përplaseshin në shkëmbinj, formonin një vorbull disa metra të gjerë dhe pastaj kalonin kthesën. Kjo vorbull, me një thellësi prej disa metrash, verës linte në breg një shtresë zalli të bardhë. Ishte një plazh i vogël shumë i bukur, të cilin mësuesja e re, Agimja, e kishte zbuluar rastësisht. Dhe, meqë ajo, kur ishte studente, merrte pjesë në ekipin e notarëve të Insitutit, porsa e zbuloi plazhin, vrapoi në dyqanin e fshatit, bleu një basmë dhe sajoi me të një kostum banjoje. Fshati ishte fill pas kthesës dhe shkolla në mes të fshatit. Porsa ishte hapur klasa e pestë, ku jepnin mësim drejtori Zef, një mësues i vjetër vendës dhe Agimja, ndërsa në fillore ishte e shoqja e Zefit, Lina, grua me tre fëmijë. Agimja u tregoi se kishte zbuluar një plazh dhe i ftoi të laheshin, por bashkëshortët nuk dëgjuan dhe Agimja nuk

e zgjati. Filloi të lahej vetë çdo pasdreke duke ndjerë kënaqësi të veçantë. Ai shkëmb, i shkëputur nga mali, aty mes vorbullës, ishte një trampolinë e mirë dhe i përshtatshëm për banja dielli. Vajza shtrihej aty me orë të tëra dhe trupi, pas disa ditësh, i mori ngjyrën e broncit.

Të rinjtë e fshatit e zbuluan shpejt vajzën e shka-thët dhe pa shumë ceremoni filluan të laheshin edhe ata në atë plazh. Natyrisht, në fillim u vinte turp, bile, kur ajo i pyeti se pse nuk i sillnin edhe motrat e tyre aty, djemtë qeshën me të madhe. Për ta, vajza mësuese kishte folur një budallallëk me brirë.

Mirëpo ditët kaluan dhe të rinjtë nuk qeshnin më kur mësuesja ngulte këmbë që vajzat fshatare të laheshin në lumë, as kur ajo erdhi një ditë me tri nxënëse, që ishin bërë lulëkuqe nga turpi. Ajo u tha djemve që të largoheshin se do të lahej me nxënëset e vogla dhe se këto të fundit kishin turp prej tyre. Djemtë u larguan pa bërë zë dhe i lanë të qeta. Pastaj nxënëset u mësuan dhe dalëngadalë nuk i shqetësonte më prania e djemve të rritur.

Plaku arriti i këputur në breg. Pas kthesës, ku fillonte vorbulla, ai e pa përsëri vajzën mbi shkëmb dhe e njohu mësuesen. Nuk ishte mbytur. Por ajo, që i bëri më shumë përshtypje, që kur zbuloi, se mësuesja nuk ishte vetëm. Në bregun e majtë të lumit, ishin disa djem dhe... tri vajza të vogla. Të gjithë me atë veshjen e lehtë të mësueses, pothuaj lakuriq. Mes djemve ai dalloj Xhemalin, nipin e tij, që porsa ishte liruuar nga ushtria. Faqet e plakut u ndezën sikur dikush t'i kishte qëlluar me dackë. I kishte pak larg dhe nuk i dëgjonte mirë se ç'bisedonin, por, kur bëri disa hapa të tjerë, u ndal, se fjalët e mësueses i vinin shkoqur. Ajo u thoshte atyre që ishin

në bregun tjetër që të përshkonin vorbullën dhe të arrinin shkëmbin duke u nisur nga një vijë e drejtë.

— Kjo është e pamundur — u përgjegj Xhemali.  
— Rryma do të na përplasë në shkëmb. Duhet të nisemi pak më larg!

— Jo — tha vajza. — Ashtu është fare lehtë. Duhet të luftojmë me valën dhe ta mundim. Provojeni!

Po asnjë nuk e provonte dot. Atëhere vajza u hodh në ujë dhe doli në breg.

— Shikoni, po e provoj unë. Kush matet me mua? Të tjerët ia dhanë gazit. Mësuesja i nxiste. Xhemali u nxeh.

— E provojmë bashkë — tha — dhe mos u mburr, mësuese. Mos harro se jemi djem!

— Nuk harroj, Xhemal. Dhe ta dish se do të të mund. Ja, bëjmë kështu. Nisemi prej këtu, arrijmë shkëmbin, hipim mbi shkëmb, hidhemi nga maja e tij dhe kthehemi përsëri. Mirë?

— Mirë. Veç po të munda, do të më qerasësh në klub, shoqja mësuese.

— Me gjithë qejf. Fillojmë!

Plaku Selim harroi se pse kishte ardhur dhe vështronte këtë garë të çuditshme. Deri në gjysmë të lumit mësuesja dhe nipi ecën paralel, duke luftuar me forcë kundër valëve që përpiqeshin t'i përplasnin tutje te kthesa. Pastaj Xhemali doli përpara dhe arriti shkëmbin dy metra para vajzës. Gjithë djemtë thirrën me entuziazëm kur Xhemali u hodh nga shkëmbi, ndërsa vajza porsa kishte arritur majën e tij. Edhe plaku nga gëzimi fërkoj duart. Mirëpo djali nuk e llogariti mirë hedhjen dhe vala e shmangu diçka metra në të djathtë, andej nga kthesa. Ndërsa ai po mendohej të përballonte rrymën, vajza u hodh

nga shkëmbi dhe me një lëvizje të rregullt të krahëve çau përpara drejt mbërritjes. Tani ato që thërrisnin me triumf ishin tri nxënëset. Plakun e kapi inati me të nipin dhe i thirri:

— Budalla, pse nuk u hodhe nga e majta? Të munda mësuësja, or burracak! — dhe u drejtua nga bregu, ku priste grumbulli i të rinjve me grushta të shtrënguar.

Xhemali munda më së fundi valët dhe arriti bregun.

Agimja u shkëput nga nxënëset dhe iu afrua Xhemalit.

— Hedhjen nga shkëmbi e bëre keq. Nesër do të stërvitemi në hedhjet. Unë kot të munda. Ti je më i shpejtë se unë.

— Ashtu mendoj edhe unë — thirri plaku dhe të tjerët atë çast vërejtën praninë e tij.

— Gjysh? Po ti pse ke ardhur? — e pyeti Xhemali.

Plaku u përgjegj duke mërmëritur:

— Ja de, të shoh se si u munde nga një femër.

Të gjithë ia dhanë gazit.

## I FORTI

— Thoni ç'të doni, po unë mendoj se Pjetri kishte të drejtë që kërkoi të largohej nga ajo brigadë. Atë e kishin fyer rëndë duke e quajtur «frikacak». Fundi, cili ishte faji i tij? Si ta parashikonte ai se orteku do të çahet përgjysmë në fund të përroit dhe do ta nxirrte në sipërfaqe të borës shokun e tij? Kjo ishte një mrekulli e rastit. Pjetri shkoi dhe lajmëroi, siç do të kishte vepruar secili nga ne. Ndërsa ata e fyejnë duke e quajtur «frikacak». Nuk është e drejtë të fyhet kështu një djalë si ai.


Ne qëndronim të shtrirë në dyshekët prej gome dhe dëgjonim, duke pirë duhan, zhurmën që përfitone shiu, i cili filloi të binte papritmas në pyllin e Kater-çiçit. Ishim pesë gjeologë që prej disa javësh kërkonim gjurmët e mineralit të magnezitit në atë reliev malor, mes bjeshkësh. Rrebeshi kishte filluar që në mëngjes dhe s'kishte të pushuar. Pylli oshëtinte si i plagosur dhe herë pas here vinte deri te ne krisma e rëndë, ngjethëse e ndonjë ahu, që e rrëzonte era. Sa herë pas rrebeshit kishim parë pemë të tilla vigane, të shkullura me rrënjë, që shtriheshin si qenie mitologjike!

Një natë përpara, në fshatin e afërt ku kishim



shkuar për ushqime, rastësisht u ndodhëm në një mbledhje rinie ku analizohej një fletërrufe, drejtuar një bariu. E quanin Pjetër. Ishte një kollos dy metra i gjatë, gjithë kocka e muskuj, një vigan i vërtetë rreth 30 vjeç. Ai, së bashku me një shok, po mblidhte dushqe, kur, nga maja e kreshtës, u dëgjua një oshëtimë. Po vinte një ortek. Ajri përçark u shndërrua në rrymë ere, që sa vinte shtohet. Ishin të dy të ngarkuar dhe e vetmja masë që mund të merrnin në ato sekonda, ishte të shtriheshin në rrëzë të drurëve. Oshëtimia u rrit në mënyrë të llahtarshme, derisa orteku i madh përfundoi në përrua. Kur erdhi në vete, Pjetri, nuk e pa shokun. Atje ku ishte shtrirë ai, tani nuk kishte as drurë, as borë, vetëm gurë e rrënjë të dala përjashta. Që nga maja e malit ku kishte filluar orteku e deri në përrua, tani shihej një rrugë e çuditshme, disa metra e gjerë, pa drurë, pa borë. Çdo gjë kishte përfunduar poshtë. Pjetri e quajti të humbur shokun e vet, prandaj vrapoi në stannet për të dhënë alarmin. Gjithë barinjët u turrën në përrua dhe për çudinë e tyre nuk patën nevojë të përdornin as lopatat, as kazmat, sepse orteku ishte ndarë më dysh. Në sipërfaqen e njërës prej gjysmave të ortekut, së bashku me ahun e shkukur me rrënjë, qëndronte i shtrirë bariu, pa ndjenja. Ende merrte frymë, kur Pjetri shkoi të lajmëronte për ortekun. Që atëhere kishte kaluar një orë. Bariun e dërguan me vig në spitalin e afërt.

Kjo kishte ngjarë në dimër, para dy muajsh. Dhe ja, tani, një bari shtatvogël, sa gjysma e Pjetrit, e quante këtë të fundit «frikacak», sepse, në vend që të vraponte në përrua dhe të përpiquej të çante ortekun, kishte humbur kohë për të kërkuar ndihmë.



Pjetri e quante veten të fyer nga kjo akuzë dhe kërkonte të largohej nga brigada e barinjve.

Tani në çadër shoku ynë, Aliu, një gjeolog i ri, mbante anën e Pjetrit dhe ngulte këmbë në të tijën.

— A e patë? Ishte diçka qesharake. Në krahasim me Pjetrin, ai që e akuzonte për qull, ishte një piçiruk. Jam i mendimit se Pjetri me një dorë mund ta ngrinte peshë atë kolopuç.

Në këtë bisedë, përveç xha Kolit, gjeologut tonë më të vjetër, shfaqëm mendimin që të gjithë. Xha Koli shikonte shiun nga dritarja e vogël e çadrës dhe vetëm dëgjonte. Ne u ndamë më dysh. Petriti mbante anën e Aliut, ndërsa unë dhe Gimi e quanim të drejtë akuzën e «kolopuçit». Kollosi Pjetër, edhe po të mos qe çarë orteku, mund ta nxirrte shokun nga bora, sepse sëpatën e kishte, dy duar të fuqishme i kishte...

— Prapë ora do të kalonte. Bariu përsëri nuk shpëtonte — ngulte këmbë Aliu në të tijën. — Nganjëherë nuk mjafton forca fizike, sado trup vigan të ketë njeriu.

— Këtu ke të drejtë — ndërhyri papritmas xha Koli dhe ne instiktivisht u kthyem nga ai.

Gjeologu plak u ngrit përgjysmë dhe, pasi shoqti cigaren në truallin plot myshk të çadrës, vazhdoi:

— Ti thua, djalosh, se nganjëherë forca fizike nuk mjafton. Unë do të shtoja edhe këtë: Po qe se forca fizike nuk ushqehet nga një zemër trime dhe një mendje e mprehtë, ajo s'është asgjë.

— Atëhere ju akuzoni Pjetrin? Nuk i jepni të drejtë atij? — pyeti Aliu.

— Rasti i tij është i veçantë. Në vështrimin e parë të duket se ai nuk ka ndonjë faj, sepse rastësinë nuk e parashikoi. Por, sipas meje, ai djalë me trup

vigan duhej të ishte më trim, më i mprehtë. Më ka rënë rasti të jem spektator i një ngjarjeje analoge, shumë vjet përpara dhe, akoma sot, kur e kujtoj atë ngjarje, një valë e nxehtë shqetësimi më turbullon ndërgjegjen.

Xha Koli lëvizi me nervozizëm, sikur donte të largonte me dorën e vrazhdë një gjë të keqe nga trupi i tij. Pastaj nxori qeskën prej nailoni, ku mbante duhanin e fortë dhe drodhi një cigare.

Ne u rregulluam në dyshekët tanë që të dëgjonim ngjarjen, ndërsa shiu vazhdonte këngën e vet monotone mbi muret e tendës.

— Kanë kaluar dhjetë vjet që atëhere. Ju ishit çunakë me pantallona të shkurtëra. Atë vit grupi im gjurmonte minerale të dobishme në luginën e Kirit. Ne ndiqnim shtratin e lumit, duke u ngjitur përpjetë, deri në gjirin e Alpeve. Kiri është lumë i çuditshëm, plot me teka të rrezikshme. Tani e ke të qetë, me pak ujë të kthjelltë dhe mund ta kalosh në këmbë. Papritmas ti dëgjon se si gjëmon dhe rritet, rritet për disa minuta dhjetëfish, duke sjellë me vete dru-rë, bagëti, që i ka zënë në breg, nganjëherë edhe njerëz. Varet nga shirat që bien bjeshkëve. Përrenjtë e shumtë, gjithë ujët dhe borën e malit të Shoshit e zbrazin në këtë lumë. Atëhere, për disa ditë, ai bëhet i pakalueshëm. Në raste të tilla, në çdo vah do të gjendet ndonjë malësor trim që i kalon shtegëtarët nga njëri breg në tjetrin me një trap të çuditshëm. Mbi dy rrëshiqa prej lëkure, të cilët i ka fryrë dhe lidhur mirë, vendos një trinë të thjeshtë. Ti hip mbi trinën, që lëkundet, ndërsa malësori, vetëm në të mbathura, noton pas teje duke shtyrë me duar trinën. Zakonisht rruga që bën trapi nga bregu në breg është më e gjatë se sa gjerësia e lumit, sepse notari

përfiton nga rryma dhe bregun tjetër e kap disa dhjetëra metra më larg se vendi i nisjes.

Në një ditë të tillë, kur lumi ishte tërbuar fare, ne donim të kaptonim në bregun tjetër. Ishim dhjetë veta. Trina e malësorit nxinte vetëm një njeri, pra atij i duhej të notonte 10 herë për të na nxjerrë të gjithë. E njihnim Palin, një burrë me mustaqe të gjata, që kishte sajuar atë trap primitiv dhe na nxirrte nga bregu në breg. Nganjëherë ne e merrnim si shoqërues në zbulimet.

Pas një ore notimi të mundshëm, në valët e tërbuara, në ujët e turbullt dhe të ftohtë, nëntë prej nesh kishin dalë në bregun tjetër. Megjithëse e lutëm të pushonte ca dhe të ngrohej në zjarrin që kishim ndezur, Pali nuk na dëgjo, por u zhyt pas trinës për të marrë gjeologun e fundit. Përtej kishte mbetur një djalosh i ri, thatim, të cilin ne e quanim filozof, sepse lexonte shumë dhe, kur lexonte, përdorte syzet. Talletsim me të, se bëhej shpejt nervoz dhe i dridheshin duart nga inati. Sidomos njëri prej nesh, Feriti, tallej më shumë se të gjithë. Feriti kishte trup të bëshëm prej atleti, që mundës dhe notar i zoti. Për ta ngacmuar «filozofin» ia merrte librin nga dora dhe vraponte, ose i merrte syzet dhe ia fshihte.

Pali kishte arritur në mes të lumit, kur ngjau diçka e papritur. Një trup pishe, që po e sillte lumi nga bjeshkët, u përplas pas trinës dhe ia shkëputi nga duart notarit. Duket se trupi e kishte goditur në brinjë, se Pali filloi të përpëllitej dhe të bënte përpjekje të mëdha që të përballonte rrymën. Për disa minuta luftoi, pastaj lëshoi një britmë të thekshme dhe na u zhduk nga sytë.

Ne vrapuam gjatë bregut. E pamë që doli përsëri

mbi ujë dhe përsëri notoi. Veçse lëvizjet e krahëve ishin të çrregullta. Vala e çonte gjithnjë poshtë.

Paralel me ne vraponte gjatë bregut dhe «filozofi». I jepnim zemër Palit, por më kot. Ai nuk donte zemër, po ndihmë. Pas dyqind metrash lumi rrëzohej në një katarakt.

Unë iu drejtova Feritit.

«— Duhet bërë diçka për të. Ti je notar i mirë...

Ai më shikoi me habi dhe qeshi.

— Vërtet jam notar i mirë, por jo i çmendur —  
u përgjegj.

— Duhet shpëtuar. Nuk duhet të arrijë kataraktin — bërtiti njëri.

— Dhe unë atë dëshiroj, me gjithë zemër. O burra, shpëtojeni — tha prapë Feriti. Kjo qesëndi e tij na shtangu. Vërtet nuk dinim si duhej shpëtuar Pali, por asnjërit ama nuk do t'i shkonte në mend të tallej atë çast. Ishte punë sekondash.

— Hidhu, Ferit, ti je i fortë, shpëtoje! — bërtita.

— Hidhu, xha Koli, po qe se ke vendosur të vdesësh me të — më tha ai.

Unë nuk dija not. Por, ta besoni, isha gati të hidhesha në atë çast, kur, njëri nga ne thirri:

— Shikoni, «filozofi» u hodh në ujë.»

Ne shtangëm nga habia. Djali humbte ndër valë, por ecte përpara me furi dhe i doli përpara Palit, të cilin rryma po e sillte si një trung me furi drejt kataraktit.

Dhe mrekullia ngjau. Ne i pamë të shtrënguar të dy si një trup i vetëm tek po i afroheshin bregut, në atë vend, ku asnjë notar nuk do të dilte fitues mbi rrymën, sepse disa metra përtej katarakti bënte zhurmë të tmerrshme.

«Filozofi» ishte treguar i mprehtë. Ne të gjithë

kishim litar me vete, por vetëm atij iu kujtua ta lidhte litarin në një pemë të bregut dhe me cepin tjetër në brez të hidhej në lumë. Ai e mundi valën dhe doli në breg me trupin gjysmë të vdekur të Palit.

Xha Koli heshti për një çast dhe thithi cigaren me afsh.

— Kaluan ditë dhe nuk tallej njeri me filozofin tonë. Ndërsa Feritin e zuri një sëmundje e pakuptueshme dhe kërkoi të largohej nga grupi.

Ne e kuptonim sëmundjen e tij. Atij i vinte turp nga ne, sidomos nga «filozofi», që ishte sa gjysma e tij me trup. I vinte turp, e brente ndërgegjija. Prandaj e kishte zor të qëndronte me ne.

Xha Koli thithi fort cigaren dhe u kollit. Ne e shikonim në heshtje, ndërsa shiu vazhdonte këngën monotone mbi muret e çadrës...

## NË ATË DHOMË TË VOGËL

Ajo ecte me kujdes dhe herë pas here ngrohte me frymën e saj duart e vogla, të skuqura nga të ftohtët. Javën e fundit kishte rënë borë e madhe, aq sa tani rruga dukej si një tunel plot zigzage. Dy anët e këtij lloj tuneli vazhës i arrinin gjer në supe. Këto ishin edhe si mbrojtje për të dhe, sa herë që i rrëshqisnin këmbët në borën e ngrirë, nuk rrëzohej. Supet i mbështeteshin në muret prej bore, ndërsa tuneli reflektonte të gjitha ngjyrat e ylberit nga dritat e rrugës që ndiznin natën dimërore në atë qytet të vogël malor. Nga rrëshqitjet e herëpashershme, tek ecte, i dukej vetja si e dehur dhe qeshte. Qeshte me të madhe, me një gaz të çiltër e tingëllues. Një gëzim të pashpjeguar ndjente në zemër atë natë.

Ishte ora nëntë e mbrëmjes.

«Tani fillon radio-posta. Derisa të arrij në dhomë, kënga e parë mbaron,» tha me vete dhe shpejtoi hapat. Por kjo e vështirësoi më shumë ecjen, rrëshqitjet u bënë më të shpeshta. Njëherë këmbët i rrëshqitën përpara dhe muret e tunelit nuk e ndihmuan. U rrëzua në shpinë, një masë bore u shkëput nga muret dhe e mbuloi të tërën me të bardhë. Kur arriti në shtëpi, dridhej si purteka. Shtyu me zor derën e

oborrit dhe desh të pinte pak ujë në çesmën, që gjendej te shkallët, por ajo ishte ngrirë. Shau dhe u fut në korridor. Që aty bërtiti:

— Vajza, po nuk e gjeta sobën të ngrohtë, do të fut duart e mia të akullta në sjetullat tuaja të ngrohata, ndërsa, po nuk e pata gati gjellën, do të ha ndonjërin prej jush.

Asnjë e qeshur nuk iu përgjegj kësaj shakaje. Vetëm zëri i Lidës u dëgjua, i thatë dhe i ftohtë:

— Shkundu mirë dhe futu brenda!

Në atë dhomë të vogël, të një shtëpie përdhese, banonin katër vajza. Detyra i kishte grumbulluar aty këto katër shoqe nga krahina të ndryshme të atdheut dhe me profesione të ndryshme. Njërin e quanin Lida, nga Shkodra, ishte mësuese e kimit në shkollën e mesme. E dyta, Beli, ishte inxhinierë në minierë. Ajo e kishte filluar punën kur miniera ishte vetëm në projekt, kurse tani aty punonin me qindra punëtorë e me dhjetra inxhinierë e teknikë. E treta, Tana, kishte inat ta thërrisnin me emrin e plotë. E quanin Sulltanë dhe për këtë emër ishte zënë sa herë me prindërit e saj. Ajo ishte teknike e mesme në postë-telegraf, por muajt e fundit, meqë postieri i qytetit kishte dalë në pension, Tana kryente dhe detyrën e tij. Në qytet e njihnin si postiere këtë vajzë të gjatë dibrane, me gërsheta. E katërta, vajza që porsa erdhi, quhej Liri. Ishte nga një kooperativë bujqësore e rrethit. Këndonte bukur. Në një festival kishte fituar medalje. Kur në qytet u ngrit estrada profesioniste, e thirrën të këndonte aty. Dhe ja, kishte një vit që Liria edhe këndonte, edhe luante si aktore në shfaqjet e ndryshme që jepte grupi.

Në këtë dhomë të vogël në fillim banonte vetëm Beli, pastaj erdhi Lida, pas saj Tana dhe vetëm muajt



e fundit u shtua edhe Liria. Kjo ndodhi rastësisht. Të trija shoqet, pasi kishin parë numrin e ri të estradës, deshën të njiheshin më afër me artisten e re. E ftuan për darkë, po Liria nuk dëgjoi, sepse do të bëhej vonë për të shkuar në fshat. Liria shkante çdo natë në fshat pas shfaqjes. Vinte i vëllai dhe e priste. Atëhere vajzat vendosën dhe e morën në dhomën e tyre. Tani ajo dhomë e vogël nuk nxinte më, sepse përveç shtretërve prej dërrase, kishin shporetin e vogël, tryezën e gjellës, (që shërbente edhe si tryezë pune), katër karrige dhe një kredencë, që e kishin blerë së bashku.

Ishin një skuadër gazmore. Hanin së bashku, gatuanin dhe pastronin sipas një dezurni javor që Lida, përgjegjësja e dhomës, e vendoste të shkruar në një karton, te dera.

Liria u çudit për heshtjen, me të cilën e pritën të tria shoqet e saj. I fluturoi gëzimi, që e kishte pushtuar atë natë, pas shfaqjes. Po ç'kishin ato?

Lida e la të ngrohej dhe të hante darkën, të cilën ia kishin lënë të ngrohtë në furrën e shporetit. Pastaj foli:

— Ty të prisnim. Kemi mbledhje.

— Mbledhje? Në shfaqjen e sotme kishim dy skeçe ku kritikoheshin ca mbledhje të kota e burokratike. Apo nuk e luan burokratin ai Ceni... — Liria qeshi dhe shikoi shoqet e saj. Beli ishte shtrirë në shtrat dhe vetëm krahun e kokën i kishte nxjerrë nga batania. Lida dhe Tana kishin afruar karriget te shporeti dhe ngroheshin. Kështu bëri dhe Liria.

— Mos u tall! Kjo mbledhje ka rëndësi — foli Tana.

— Mirë, moj... O burra, mbledhje! Jam e lodhur sonte dhe desha të fle, por... meqë ju mendoni... Si është puna?

— Beli ka bërë lutje për transferim. E pashë lutjen në komitet. Kërkon të shkojë në qytetin e saj, ose kudo gjetkë. Dhe nuk na ka treguar.

Këto fjalë të Lidës, të thëna ashpër, i bënë të heshtnin dhe të mendoheshin gjatë tri të tjerat.

— Po më vjen keq... — tha më së fundi Liria. — U mësua me aq shumë me njëra-tjetrën, saqë... as më shkonte mendja se mund të ndaheshim ndonjëherë. Po fundi, kjo do të ndodhte një ditë...

— Si do të ndodhte? — pyeti Tana. — Të largohemi hajdutshe, nga njëra-tjetra, thua ti?

— Jo hajdutshe, por, në një mënyrë apo në një tjetër... Po, cili qenka faji i Belit? Unë nuk e kuptoj.

— Pse nuk na tregoi se ka bërë lutje? Pse të fshihet nga ne që i kemi kartat e hapura për njëra-tjetrën? — foli Lida.

— Nuk na tregoi sot, do të na e tregonte një ditë tjetër. Tre vjet punoi këtu. Ka të drejtë të kërkojë transferim.

— Kështu mendoj edhe unë. Po këto... — desh të shfajsohej Beli, por Lida e ndërpreu.

— Ti mos folë! Na lerë ne të flasim. Kujton ti se nuk e dimë ne pse do të largohesh?... E dimë.

— Po unë...

— Hesht! Të tjerët mund t'i gënjeshtrojnë, por veten dhe ne kurrë! Ti do të largohesh, sepse të gënjeu ai, Sandri, dhe ty tani të vjen turp.

— Po të ishte turp, ne do ta thoshim — foli Tana. — Ti na e tregove dashurinë tënde dhe ne të mbrojtëm. Je shoqja jonë. Pse kërkon të ikësh? Cili është turpi yt?

Liria, që po dëgjonte këtë breshëri fjalësh, tundi kokën dhe qeshi me të madhe.

— Ama për këtë qenka mbledhja? Për Sandrin kërkon të ikësh ti, moj Beli?

— E kuptoi artistja më së fundi... — u tall Lida.

— Rri, shoqja përgjegjëse, në mbledhje nuk i pritet fjala tjetrit. Sa për Sandrin, besoj se i kam dhënë një mësim të mirë sot, në drekë. Tani ai duhet të kërkojë të ikë nga ky qytet, jo Beli.

Vajzat e shikuan me vërejtje. Liria qeshi përsëri.

— Kishte disa ditë që më vardisej. Një ditë më hodhi edhe lule në skenë. Kishte parë në ndonjë film. Unë nuk mund ta shihja me sy për atë që i bëri Belit dhe çuditesha si kishte guximin të më vardisej. I tregova Cenit. Ai më tha se Sandri ishte krenuar se do t'i kalonte me radhë katër banoret simpatike të dhomës. «Ta tregoj unë qejfin, maskara», thashë. Dhe i lashë takim në restorant. Ishte dita kur prindërit vijnë të marrin rrogën time. Ai erdhi. E prezantova me prindërit. Ai u shtang. Shikoi rreth e rrotull dhe nuk u ul. I vinte turp nga veshja e prindërve të mi. «Pse nuk ulesh? i thashë, gjoja pa kup-tuar. Ai që më do mua, duhet të dojë dhe prindërit e mi.»

Babai dhe nëna nuk flisnin. Disa shoferë, bri nesh, qeshën me të madhe. Njëri tha: «Mirë ia bëri kokoroçit. Është një ai...»

Sandri u ndez në fytyrë dhe u largua. Kur po delte, i thirra: «Të fala nga dhoma e katërshe». Ai nuk e ktheu kokën, por qeshjet në kor të shoferëve i dëgjoi mirë.

Liria tregonte thjeshtë dhe qeshte. Vajzat e dëgjuan në heshtje. Pastaj u çelën. Në fillim qeshi Lida, pastaj Tana... pastaj edhe Beli, e cila u ngrit nga shtrati dhe e përqafoi Lirinë.

— Mbledhja mbaroi me sukses. Nesër shko tërhiq lutjen, foli Lida. — Liri, na këndo një këngë.

— Pse, moj, ç'u bëra unë? Dua të fle tani. Më pritët ftohtë. Nuk ka këngë sonte — u përgjegj vajza, gjoja me inat.

Tri shoqet nuk folën. E dinin se ajo do të këndonte. Liria u zhduk në sy të tyre dhe u fut në batanie. Bile mbuloi edhe kokën. Pastaj u dëgjua kënga e saj. Në fillim e mbytur, por, kur batania u flak në fund të këmbëve, kënga buçiti me forcë...

## GJETHET E DUSHKUT

Atë ditë Vata qe caktuar nga brigadieri të priste gjethe dushku në Ograjen e Kuqe. Ky emër i kishte mbetur jo nga ngjyra, sepse atëhere duhet të quhej ograja e verdhë, po nga një ngjarje e shëmtuar, një vrasje e madhe që kishte ndodhur gjysmë shekulli më parë dhe që kishte larë me gjak këtë shpat mali, i cili ndante dy fshatrat. Shkak për këtë vrasje u bënë gjethet e dushkut, ushqimi i dhive për dimër. Secili fshat ngulte këmbë se i takonte atij dhe sherri zgjati disa vjet. Një ditë të diel shkuan për të prerë gjethe të dy fshatrat menjëherë. Po në vend të gjetheve, me këmesat e sëpatat prenë njëri-tjetrin. Që nga ajo ditë, Ograja u quajt e kuqe dhe njerëzit e të dy fshatrave u bënë armiq me njëri-tjetrin.

Kjo ngjarje i takon së kaluarës, sepse pas çlirimit armiqësia u shua, madje filluan edhe të lidheshin martesat mes dy fshatrave, ndërsa Ograja e Kuqe u nda përgjysmë, me një gardh. Më vonë gardhi u prish, sepse të dyja fshatrat u bashkuan në një kooperativë bujqësore.

Vata e kishte realizuar normën, madje e kishte tejkaluar me dy mullarë. Po, meqë kohë kishte akoma dhe muzgu porsa kishte nisur të kuqëlonte atje tej

në luginë, vendosi t'u hidhte edhe një sy mullarëve, t'i forconte e t'i mbushte disa prej tyre. Shpati binte pak i pjerrët dhe zgjatej deri poshtë, te tarracat e reja të kooperativës të mbjella me patate. Deri atje zgjateshin edhe njëzet e dy mullarët e vegjël me gjethe të njoma dushku, që Vata tani po i kontrollonte.

Nuk kishte shkuar akoma në fund, kur u ndal, sepse diçka i tërhoqi vëmendjen. Dy hije lëvizën në muzg pas njërit nga muret e tarracave.

«Me siguri ndonjë çift të rinjsh. Ka hyrë dashuria edhe në fshatin tonë», mendoi me vete. Vazhdoi punën. Dësh të mos i trazonte të rinjtë. Ai porsa i kishte mbushur të tridhjetat. Ishte martuar fare i ri, pa i mbushur të njëzetat.

«Në qytet, mendoi, ka burra të moshës sime që tani vendosin të martohen, ndërsa unë u martova të nesërmen e kthimit nga ushtria».

Të rinjtë bisedonin e qeshnin atje, pas murit të tarracës. Tani zëri i tyre filloi ta shqetësonte. I lindi një dëshirë e marrë që t'i shihte, t'i njihte... edhe ata ta shihnin, ta njihnin dhe të vraponin nga turpi. Ata të vraponin dhe Vata të qeshte e t'i thumbonte.

U afrua, gjoja për të kontrolluar mullarin e fundit, megjithëse nuk e kishte mendjen fare aty. U afrua me hapa të lehtë, pa zhurmë. Muzgu tani po ia linte vendin errësirës. Një erë e freskët nisi të frynte nga veriu. Ograja e Kuqe filloi këngën e saj, këndonin gjethet e dushkut, frushullonin. Vata e kishte mendjen te një frushullimë tjetër, frushullima e dashurisë së dy të rinjve. Dhe tani e kishte fare pranë atë frushullimë. Ja, pas murit, në anën tjetër, mund të ngrinte kokën, të zgjaste duart dhe të prekte kokët e dy të rinjve, të qeshte me frikën e tyre, të gajasej...

Por duart filluan t'i dridheshin, djersë të ftohta i bu-  
luan në ballë dhe në zemër ndjeu sikur dikush i ngul-  
një thikë të mprehtë. Në zërin e vajzës, që qeshte,  
Vata njohu të motrën, Danën. Qenka ajo, me të fejuar-  
rën e saj, Dashin, pas murit të tarracës. Ata qeshin  
dhe ndoshta tani po puthen... po... puthen... te Ograja  
e Kuqe.

Vatës iu prenë këmbët dhe, që të mos binte, u  
mbështet pas murit. Ndryshe e nisi dhe ndryshe i  
doli. Desh të tallej me dy dashnorët, kurse tani i du-  
kej, se qenë ata që talleshin me të. Një zemërim i  
gufoi përbrenda dhe shtrëngoi këmesën. Diçka e fje-  
tur u zgjua nga thellësia e shpirtit të tij, diçka e  
zezë, që Vata mendonte se kishte vdekur. Ograja e  
Kuqe frushullonte. Këndonte këngën e saj që lindi  
gjysmë shekulli më parë. Ajo këngë hynte thellë në  
mendimet e Vatës, e ngacmonte, e cimbiste.

U ngrit aq me rrëmbim, sa një gur i murit u  
shkëput dhe ra në këmbët e tij. I gjakoši gishtat. Po  
Vata as që e ndjeu dhembjen. Një dhembje më e  
madhe e mundonte. I pa ata. Edhe ata e panë dhe u  
trembën. Në fytyrën e prishur të Vatës lexuan diçka  
të keqe. Vajza lëshoi një britmë dhe vrapoi. Dashi  
ngau pas saj dhe e arriti.

— Dana... Dana... — thirri Vata si i çmendur. —  
Ndalo, bushtër!

Të rinjtë u ndalën. U kthyen nga ai.

— Mos shaj, Vatë. Nuk të ka hije — foli Dashi  
qetë.

— M'u shporr sysh, ti! Lëre Danën dhe ik —  
gulçoi Vata.

— Nuk e lë. Jemi të fejuar, Vatë. Ti e di!

— Nuk është akoma jotja. Kur të martohesh, po.  
Tani është imja.

— Jotia?

— Motra ime.

— Kujtova se the lopa ime. Eja në vete, Vatë! Është turp. Ne po shkojmë tani. Danën po e përcejell në shtëpi. Askujt nuk do t'i tregojmë për këto që the. Nuk zemërohemi me ty.

Ata u kthyen dhe ecën ngadalë drejt fshatit.

— Ndalo, Danë, do të të vras... — thirri Vata, po nuk luajti nga vendi. Ato fjalë sikur ia tha Ograjës së Kuqe. Të rinjtë vazhduan rrugën e tyre. Vata mbe-ti pas murit të tarracës, me këmesën në dorë. Mendimet më të zeza i silleshin në mendje, si ato fluturat qorre që sillen rreth një llambe të ndezur.

U kthye në shtëpi vonë. Po e prisnin me sofër shtruar. E shoqja i ndihmoi të lahej dhe e ftoi në sofër. Dhe Vata shkoi atje duke çaluar. Këmba e gjakosur nga guri i tarracës tani i therte. U ul në sofër dhe ndeshi në vështrimin e së motrës. Ishte një vështrim i ëmbël, i ngrohtë. Fliste shumë Dana me atë vështrim plot dashuri prej motre. Po Vata tani nuk e kuptonte. Vështrimit të së motrës iu përgjegj me një varg fjalësh të ftohta dhe të egra.

— Ngrehu nga sofra dhe hiqmu sysh! Ngrehu, bushtër, shpejt!

Vajza u skuq nga turpi dhe u ngrit. Vrapoi në dhomën tjetër.

— Pse kështu, o bir? Ç'të ka bërë jot motër që e shave? — pyeti e ëma, së cilës i kishte mbetur luga në dorë.

— E di ajo përse — u përgjegj thatë.

— Nuk u dashka ta dimë ne? — pyeti Liza, gruaja e Vatës.

— Derisa e di Vata, ju nuk keni punë. Ai është



burrë, ai di se ç'bën me të motrën — i vuri kapak babai.

Darka kaloi në heshtje të thellë. Dëgjoheshin vetëm lugët që trokisnin në pjatë. Vata ra vonë të flinte, pasi bisedoi gjatë me të atin. Dashi doli njeri i poshtër, të cilit i duhej treguar si luhet me nderin e një vajze malësore. Ai duhej ta merrte Danën të nesërmen, ose...

Kur shkoi në shtrat, Lizën e kishte marrë gjumi. Por ai e zgjoi.

— Pse më zgjove? Dua të fle! — i tha e shoqja.

Vata qeshi. I vuri dorën te flokët dhe e përkëdheli. E donte shumë të shoqen. Dashuria e tyre kishte qenë e madhe këta vjet martesë.

Po sonte e shoqja ishte e zemëruar. Nuk e la ta përkëdhelte. U ngrit nga shtrati.

— Moj, po ç'ke sonte? — pyeti Vata i çuditur.

— Ose më lerë të fle, ose u ngrita e dola në kuzhinë — u përgjegj Liza, e skuqur nga zemërimi.

— Përse? Ç'të kam bërë?

— Sontë më dukesh i pëshpirë, si një plak i keq...

Vata qeshi me të madhe.

— Mos qesh, se po zgjon djalin!

— Si të mos qesh. Ç'janë këto budallallëqe që thua? Unë, plak i keq?

— Po, bile më tepër se plak... një i sëmurë... sepse ke harruar shumë gjëra.

— Kam harruar, çfarë?

— Kohën tonë të fejesës. Ograjën e Kuqe... pri-tat që më zije sa herë kthehesha nga puna. Rrije pranë mullarëve, gjoja duke punuar, po unë e kuptoja se më prisje mua. Mbetesha pas shoqeve, kinse po lldhja këpucën. Po shoqet, që e dinin punën, nuk flisnin fare, qeshnin dhe vazhdonin udhën. E ne për-

qafoheshim, duke u ruajtur nga sytë e fanatikëve. Fshiheshim, sikur po e vidhnim dashurinë tonë, megjithëse ishim të fejuar. E tillë qe koha, atëhere. Porsa ishte formuar kooperativa. Të kujtohet?

— Më kujtohet, po ç'hyn kjo në zemërimin tënd?  
— tha Vata.

Liza qeshi idhshëm, duke e parë të shoqin në sy:  
— Kisha edhe unë vëllezër, Vatë. E dije që kisha vëllezër?...

Liza priti përgjegjen e të shoqit. Vata nuk foli. Gruaja u ngrit dhe u vesh.

Burri u tremb dhe e kapi për krahu.  
— Lizë, mos luajte mendsh? Ku po shkon tani, në mesnatë? Është turp!...

Liza qeshi përsëri. Foli duke i theksuar fjalët:  
— Dana ka rënë të flerë pa ngrënë. Po shkoj t'i jap darkë. Nesër do të dalë në punë me ne. Apo të mos shkoj? Si thua?..

Çishtat gjithë kallo të dorës së Vatës u liruan ngadalë nga krahu i gruas, që i kishte sjellë shpinën të shoqit dhe priste përgjegje. Po përgjegje nuk pati.

Vata heshti për një kohë të gjatë. Dëgjonte frushullimën e gjetheve atje larg, tek Ograja e Kuqe. Përsëri i theri zemra. Po tani ishte një therje tjetër. I dukej sikur e shoqja e kishte qëlluar me pëllëmbë në fytyrë, ndaj faqet i digjnin. Liza hapi derën dhe doli, ndërsa Vata mbeti një hop me vështrim të ngulur nga dhoma e së motrës.

## «TURBULLUESI»

Brigadier Toma turfullonte në zyrën e kryesisë së kooperativës bujqësore.

— Dëgjo, or shoku kryetar! Ose unë, ose Kola në brigadë. Zgjidhni e merrni. Nuk durohet më.

Kryetari mudohej t'ia ulte nervat brigadierit me fjalë të buta.

— Mos u bëj nevrrik, Tomë! Mos e merr punën me grysh. Fundja, nuk ka bërë ndonjë krim! Hiqe në një anë dhe bisedo shtruar me të.

— Po nuk i mbushet mendja, o byrazer. Nuk i mbushet mendja dhe pikë. Ka një kokë ai, që as tokmaku i trasesë nuk e zbut. Ku është parë, bre, të vendosë burri i botës çadrën portative në qoshe të arës, të sjellë shtratin, tryezën e karrigen portative, në çadër? Pse ku jemi këtu? Në shtëpi pushimi apo në punë bujqësore?

— Punën a e bën? Normën a e qet? Le të rrijë në kohë pushimi sa të dojë në çadër. Edhe radion le ta sjellë aty. Nuk na prish punë — përgjegjej kryetari. Por këto fjalë e xhindosnin më tepër brigadierin.

— Si, bre, nuk na prishka punë? Na prish që ç'ke me të. Pjesëtarët e tjerë të brigadës, sa vjen

pushimi i drekës, ose zënë hijet, ose turren në shtëpi për të bërë pushim. Ndërsa Kola sikur ua bën për inat, futet në çadër dhe ia kris gjumit. Le pa, na ka marrë edhe sahat me zile. Fle një orë dhe del në arë duke u kapardisur.

— Punën a e bën mirë?

— E bën, nuk them se nuk e bën. Madje e kalon normën, por...

— E çfarë atëhere?

— Po të tjerët? Të bëjnë sehir ata? Shkurt, për mendimin tim, Kola është borgjezuar, prandaj, ose ma hiqni nga brigada, ose po largohem unë.

— Do ta shikojmë atë punë — e mbylli kryetari sa për ta hequr qafe brigadier Tomën. Kur ai doli, thirri agronomin.

Agronomi erdhi i bërë gjithë baltë.

— Më thirre, shoku kryetar?

— Po. Për Kolën e brigadës së tretë. Di gjë ti se na paska marrë shtëpinë me vete kudo që shkon në punë?

— E di dhe më pëlqen shumë ideja e tij — u përgjegj agronomi.

— Ai mund të ketë shumë ide, po a na prishin, a na rregullojnë punë këto ide, kjo ka rëndësi.

Agronomi qeshi. Pasi ndezi një cigare, shpjegoi: — Kola kursen energjitë e veta. Mendoni pak, nga shtëpitë e kooperativistëve deri te fronti i punës janë d'isa kilometra rrugë. Pushimi i drekës është dy orë. Sa shkojnë në shtëpi fshatarët, koha u ikën dhe, përveç kësaj, lodhen së tepërmi. Këtë lodhjen kursen Kola. Veç së mirës, unë, këtu, nuk shoh gjë të keqe.

Kryetari krojti kokën.

— Dakord xhanëm, fundi edhe unë nuk shoh gjë

të keqe, por gjithë ato salltanete «portative», (fjalën «portative» kryetari e theksoi me qëllim) sikur teprohet ca. Deri te sahati me zile...

— I kam thënë të sjellë edhe radion, edhe veglat e kafesë. Do t'i sjellë. E ku ka më mirë — tha agronomi.

— Sikur diçka nuk vete këtu. Diçka më duket e tepërt, po se çfarë, nuk e di. E nuhas, po s'e kap dot — tha kryetari, por tjetri ia priti:

— Duket e tepërt, se atë, që po bën Kola, duhej ta bënim në në çdo brigadë fushe. Sikur të ndërtoheshin ca...

— Ama ndërtime? Shpenzime? Aty të rreh çekani ty. Ne na vlojnë trutë me hangarët dhe stallat... Lëri ato, lëri dhe thuaj Kolës ta heqë çadrën, se vret keq.

— Nuk i them. Pse ta heqë?

— Mos e zgjat. Duhet ta heqë, përndryshe brigadier Tomë lë brigadën.

— Punë e madhe se po e lë! Do të na bënte nder të madh. Ai duhet zëvendësuar sidoqoftë...

U zunë me fjalë kryetar e agronom për çadrën e Kolës dhe për zotësinë e «pazëvendësueshme» të Tomës dhe si përfundim u vendos që vetë kryetari të shkonte në brigadën e tretë dhe të shihte gjendjen.

Të nesërmen kryetari u nis me kaloshinë në brigadën e tretë. Fronti i kësaj brigade ishte te tokat e reja, që kishte hapur kooperativa vitin e kaluar përtej malit. Kaloshina nuk arriti deri në vendin e caktuar, kështu kryetarit iu desh të bënte ca rrugë malore në këmbë. Ndërkohë qielli ishte mbushur me re dhe nisi një shi i fortë. Vërtet një shi pranverë, por kryetari, ama, u bë qull. Ishte kohë dreke. Kryetari kërkoi brigadën. Ai nuk pa asnjëri, përveç brigadierit

Tomë, të strukur në një rrënjë ahu. Kryetari iu afrua.

— Po ti? Ç'po bën këtu?

— Ja, po pres të kalojë kjo re shiu.

— Ku i ke njerëzit?

— Atje, te borgjezia — tha brigadieri dhe tregoi me gisht një qoshe të arës, ku ishte ngritur një çadër. Prej andej dëgjohej kënga, dikush i binte dhe çifte-lisë. Kryetari shikoi me vëmëndje dhe kruajti kokën, gjë që e bënte shpesh, kur ishte në hall. Pastaj shtoi:

— Pse nuk shkove dhe ti aty të mbrohesh nga shiu?

Toma turfulloi me inat.

— Unë të vete aty? Ngordh këtu dhe nuk i shklas në çadër.

— Ndërsa unë po vete, se jam bërë qull — tha kryetari dhe u drejtua te çadra. Kënga sa vinte e shtoej. Pastaj ajo pushoi dhe u dëgjuan lajmet.

«Paska sjellë edhe radion,» mendoj kryetari dhe bëri zë. — A doni miq, o shokë e shoqe?

— Më së fundi t'u mbush mendja, o brigadier, — u dëgjua zëri i Kolës — eja eja, ti kot e ke që zemërohesh me ne.

Kryetari u fut në çadër. Ajo ishte plot me burra e gra, djem e vajza. Kur e panë kryetarin, të gjithë lëvizën për t'i bërë vend te shtrati, ku ishte dhe agronomi. Kryetari u ul dhe mori një cigare nga disa kuti, që iu zgjatën. E drodhi në heshtje. Askush nuk fliste. Dikush mbylli radion.

— Pse e mbylle? Hape të dëgjojmë lajmet! — tha kryetari.

— Thamë se mos ju bezdis — ngacmoi Kola.

Kryetari qeshi. Foli pas pak.

— Bukur e paske menduar, o Kolë! Gjë e mirë kjo çadër.

— E mirë, e mirë, por duhej të mendonte kryesia para Kolës — foli një grua guximtare. Kryetari tundi kokën:

— Ke të drejtë, o Marë. Kështu duhej. Po unë besoj se nuk është vonë. Apo jo, agronom?

Që nesër do të fillojmë ndërtimin e barrakës.

Të gjithëve u qeshte fytyra nga gëzimi.

## FIJET E HOLLA

Në shkollën e mbrëmjes zhvilloheshin provimet e pjekurisë. Një shok im, mësues i letërsisë në atë shkollë, më ftoi të dëgjoja si përgjegjeshin nxënësit e tij punëtorë. Dhe unë shkova. Gjatë atyre pak orëve që ndenja në tryezën e rreptë të komisionit, për të cilën secili prej nesh ruan kujtime të ndryshme, të bukura e të hidhura, u bëra shkas për një ngjarje që dua t'jua tregoj:

Pas një punëtori xhenerik, që u përgjegj shumë mirë, i erdhi radha një gruaje të re, që punonte në fabrikën e sapunit. Ajo kishte mbushur me një shkrim të hollë shumë faqe fletoreje. I renditi ato sipas pyetjeve në tryezën e vogël para nesh, vuri duart mbi to, pastaj ngriti kokën dhe na vështroi në sy. Priste të fillonte.

M'u duk se e njihja, diku e kisha parë. Flokët e saj të gjatë, me fije aq të holla dhe çuditërisht të zeza, si të lyera me bojë, ishin të njohura për mua. Shikova emrin e saj në listë, e vrava mendjen, po nuk më kujtohej se ku e kisha parë. Papritmas ndodhi diçka. Gruaja u skuq si flaka. U shqetësua nga vështrimi im dhe e ndërpreu fjalën. Ajo më vështronte nganjëherë dhe duart i dridheshin. Më kot e pyetëm ç'ki-



shte, më kot i dhamë zemër. Mësuesi i lëndës i tha të ulej në ndonjë bankë dhe të qetësohej. Ajo as nuk fliste, as nuk lëvizte.

— Mos duhet të dal unë nga salla? Ndoshta e shqetësoj — i pëshpërita shokut tim.

— Ka të ngjarë, — u përgjegj ai — sepse si nxënëse ka qenë e shkëlqyer. Pa ta provojmë pa ty. Sidoqoftë prit në korridor. Mos ik!

Unë dola në korridor. Aty prisnin shumë nxënës të tjerë punëtorë që t'u vinte radha e të futeshin në sallë. Porsa dola, m'u grumbulluan që të më pyesnin kush përgjegjej, a bënte shumë pyetje përfaqësuesi dhe si u ndanë ata që e dhanë provimin. Po bisedoja me ta miqësisht, përgjegjësja për ndonjë gjë të paqartë që kishin. Kaloj kështu gjysmë ore. Pastaj porta u hap dhe gruaja e çuditshme doli. U fut dikush tjetër. Desha të futesha dhe unë, por nga prapa dikush më thirri me emër.

— Shoku L., më falni një minutë.

Solla kokën. Ishte gruaja me flokë të zez. Djersët i shkonin çurg, siç ngjet me disa në provime dhe fytyrën e kishte akoma të skuqur. E shikova, buzëqesha dhe prita se ç'do të më thoshte.

— Mos u zemëruat që ju bëra të dilnit? — tha ajo.

— Pse të zemërohesha? Kjo ngjet në provime. Po si u ndatë? — foli unë.

— Mirë u ndava, po kjo nuk ka rëndësi. Nuk i kam frikë provimet, sepse mësoj. Po ju nuk e kuptuat përse u shqetësova? Nuk më njihni?

— Më dukeni e njohur, po nuk ju mbaj mend. Mos kenë qenë nxënësja ime?

— Jo. Në klasën tonë nuk jepnit mësim, por ishit mësues në shkollën tonë. Punonim së bashku

në aksion, ju ftonim të recitonit në mbrëmjet e dëfrimit. Nuk ju kujtohet?

— Këto, në përgjithësi, më kujtohen, por ju... Nejse, po ç'lidhje kanë këto me tronditjen tuaj? Këtë nuk e kuptoj.

Gruaja e re më vështroi thellë në sy dhe u skuq më tepër.

— Kur ju pashë ju, — vazhdoi ajo — m'u kujtuan shokët e shoqet e mia të klasës. Ata tani kanë mbaruar shkollat e larta, ose, së paku maturën e kanë marrë qëkur. Ndërsa unë e lashë shkollën përgjysmë, unë që isha mësuar të merrja çdo vit së bashku me dëftesën dhe një fletë lavdërimi. Unë që kisha sajuar aq ëndërra të bukura për të ardhmen, që doja të bëhesha mjeke...

Qeshi idhshëm dhe tundi kokën si për të larguar një mendim të keq. Flokët, ato fije shumë të holla dhe shumë të zeza, që të tërhiqnin vëmendjen, i ranë mbi ballë dhe i mbuluan sytë. Ajo i largoi me gishtërinj.

— Pse e latë shkollën? — pyeta. Ajo foli përsëri:

— Këtë pyetje ma bënit vazhdimisht atë natë që erdhët në shtëpi, ju dhe mësuesi im kujdestar. Bile bëtë aluzion për prindërit e mi, se mos ishin fanatikë, se mos më hoqën nga shkolla për të më fejuar. Ndërsa unë qaja dhe çuditesha me ju. Ju duhet ta dinit shkakun. Mësuesi kujdestar ishte ai që më bëri ta lija shkollën që e doja aq shumë, bile të prisja edhe flokët, këto fije të holla e të zeza, me të cilat dikur mburresha. I qetha si djemtë. Si nuk e vutë re ju që unë isha me shami në kokë?

Mësuesi im kujdestar mund të jetë i mirë — vazhdoi ajo. — Po ja që, një veprim i tij pa takt, mua më kushtoi shumë. Na mblodhi një ditë pas mësimit,

pikërisht atë ditë që te ne kishte ardhur një ekip shëndetsor dhe na kishte kontrolluar një nga një për higjienën personale. Mësuesi ishte nervoz. Foli për rëndësinë e higjienës, se si ne duhej të ishim shembull për të gjithë, se nuk na lejohej të bëheshim objekt diskutimi për pastërtinë e të tjera fjalë. Madje shtoi që paskësh në klasën tonë edhe ndonjë vajzë me parazitë në flokë. Atë çast unë buzëqesha. Ishim gjashtë vajza në klasë. I njihja të gjitha, vizitonim njëra-tjetrën në shtëpi, prandaj më erdhi për të qeshur me fjalët e mësuesit. Mësuesi e pikasi buzëqeshjen time dhe u bë nervoz. M'u drejtua:

«Ti qesh, Vjollca, po unë për ty e kisha fjalën. Mjeku tha se ke ca puçra e kemi frikë se mos ua ngjit të tjerëve».

Kaq mbaj mend. U trondita shumë. Shoqet më çuan në shtëpi për krahësh. Qava gjithë natën, e bëra qull jastëkun nga lotët. Nga turpi nuk dola nga shtëpia për tre muaj, derisa puçrat u zhdukën. Ndërsa shkollën e lashë. M'u ftoh që atë natë.

Ajo heshti.

Unë i thashë:

— Tani më kujtoheni. Po, unë përsëri pyes, pse e latë shkollën? Vërtet mësuesi veproi keq, por ky nuk ishte një shkak për të lënë shkollën. Të isha unë në vendin tuaj, nuk do të shqetësohesha. Derisa klasa të njihte, pse të kishe turp...

— Edhe unë të isha në vendin tuaj, ashtu do të veproja. Po ja që jemi të ndryshëm. Ju jeni ju, unë jam unë, secili ka zemrën e vet, sedrën dhe personalitetin e vet. Unë atëhere isha 16 vjeçare... vajzë me sedër, ajo që një goditje e rëndë për mua. Ju duhej ta ndreqnit gabimin dhe jo të binit në gabimin tjetër, të fyenit dhe prindërit e mi duke i akuzuar për fana-

tikë, kur nuk ishin të tillë. Kjo më shtoi më tepër bindjen se nuk kisha ç'bëja më në atë shkollë. Pastaj ju ratë në gabimin e tretë. Nuk lejuat që babai të më çonte në një shkollë tjetër. E quajtet veten të fyer, ndërsa e fyera isha unë.

Bisedën tonë e ndërpreu shoku im, që kishte hapur derën dhe më thërriste në sallën e provimit. Ajo qeshi.

— Shkoni — tha — dhe më falni.

— Jo, jo, ai që duhet t'ju kërkoj falje jam unë, është shoku im. Ju e pësuat, po ne kemi të bëjmë me shumë si ju.

Duhet takt, keni të drejtë.

Kaq munda të nxirrja nga goja dhe u futa në sallën e provimit.

## KANDIDATJA E FUNDIT

Ajo rrinte në skaj të korridorit, e mbështetur në parmakët e një dritareje të hapur. Për çudi, tani s'ndjente më frikë. Vendin e frikës e kishte zënë plogështia. Nuk dridhej më, por vështronte e ftohtë, me moskokëçarje, si ai atleti, që futet në garë, i sigurt, se do të zërë vendin e fundit.

«Pse erdha këtu? Ç'budallallëk! Ku mund të matem unë me këta?» thoshte me vete, kur shihte një grumbull vajzash e djemsh para portës së mbyllur, ku ishte varur një tabelë: «Komisioni i provimit» dhe poshtë saj: «Qetësi!» Që të gjithë ishin veshur më së miri, sidomos vajzat, që dukeshin si flutura me ato fustane të bukura, me flokët e prerë shkurt. Qeshnin e bisedonin plot gjallëri, tek prisnin radhën për të hyrë në provimin e pranimit. Atë çast, njëra nga vajzat po recitonte një vjershë dhe shoqet e përgëzonin.

«Pse erdha këtu? pyeti veten për të dytën herë ajo. Ç'm'u desh theatri! Vajta e dëgjova Aliun, budallaqja. Ke talent, ke talent... më thoshte ai. E ç'talent paskam? Recitoj mirë? Ajo vajza që recitoi tani do të tallej me mua, po të më dëgjonte. Jam dalluar në grupin e theatrit të shkollës? E pastaj? Aty, vetëm skeçe shfaqim. E kush më lavdëronte? Mësuesi i le-

tërsisë, nxënësit e ndonjë prind. Kurse këtu, në komision, janë artistë të popullit, artistë të merituar, artistë të kryeqytetit... Ç'marrëzi! Kur të mos e fitoj provimin, do të kthehem në shtëpi e turpëruar. Shogeve të mia do t'u dalë bursa për në universitet, kurse unë...»

Porta hapej herë pas here. Vajza shikonte ata që delnin. Vërtet ishin të qullur në djersë, por ama fytyra u qeshte. Përnjëherësh rreth tyre grumbulloheshin të tjerët.

Vajza nuk dëgjonte se ç'flisnin, bile as që interesohej fare. Shikonte atë grumbull fustanesh plot ngjyra, pastaj kthente sytë te fustani i saj prej basme, të cilin Aliu ia kishte blerë një ditë para se ajo të nisej në kryeqytet.

«Së paku të vinte edhe Aliu me mua! Pikërisht tani e gjeti të shkojë në ekip nëpër katunde?» mendonte vajza.

Nga salla e komisionit u dëgjua një këngë. Këndonte një vajzë me zë të ëmbël e tingëllues. Në korridor heshtën të gjithë.

«Oj?! Këta kërkokan edhe këngë? Edhe kjo më duhej! Po unë nuk e di të plotë asnjë këngë!» Dhe vërtet, pasi i kujtoi të gjitha, u bind se çdo këngë i dinte një deri dy shtrofa, jo më tepër.

Kënga ushtonte ëmbël nëpër gjithë korridorin.

Ajo u fut në sallë e fundit. Zakonisht në shkollë ajo i tallte nxënësit që mendonin se, duke u futur të fundit në provim, mund të përfitonin nga lodhja e pjesëtarëve të komisionit. Tani u gëzua që e thirrën të fundit. Së paku nuk do ta mbanin shumë, nuk do të talleshin me të. Do t'i thoshin: «S'ke talent dhe...

Udhën e mbarë.» Më mirë kështu. U pa kjo punë, humbur se humbur.

Prapa tryezës së madhe ishin gjashtë veta, katër burra e dy gra. Në mes tyre vajza njohu një artist të popullit. E kishte parë në qytetin e saj të largët, kur Theatri Popullor kishte shfaqur një dramë. Dhe sa e kishte duartrokatur! Njohu edhe njëerën nga gratë, atë më të motshmen, një grua të shëndoshë me shikim të lodhur. E kishte parë diku, por se ku s'e kujtonte. Të tjerët nuk i njihte. Kur hyri, nuk ndjente asgjë, ishte si e mpirë. Ata që merrnin në provim, me të vërtetë ishin të lodhur. Fytyrat u ishin skuqur dhe e shikonin me mospërfillje. Madje, njëri as që e vështroi fare, por vazhdoi të lexonte gazetën. Vajza tek ai i nguli sytë. Ishte një mesoburrë i shëndoshë, me ballë të gjerë. Ai kishte mbështjellë rreth qafës një shall të mëndafshhtë, të bardhë dhe vajzës i vinte çudi si e duronte atë shall tani, në pikë të vapës.

Gruaja e shëndoshë, e cila qëndronte në mes artistit të popullit dhe gruas tjetër më të re, drejtonte pyetjet. Vajza e mori inat që në fillim. Gruaja qeshi me përdhunë, më tepër për të bërë zakonin, se sa për t'i dhënë zemër kandidatës.

— E, moj çupë e mirë, na thuaj ç'ke përgatitur?

Vajzës iu duk se ajo pyeste, siç pyet një klient i ngopur në restorant, ku ka hyrë vetëm sepse është kohë dreke, dhe, megjithëse ka përpara menynë, i thotë kamerierit: «E ç'do më japësh?» i sigurt, se s'do t'i pëlqejë asnjë gjellë.

Vajza u skuq, heshti një çast e pastaj tha me zë të qetë:

— Ndoshta është më mirë të iki që tani.

— Pse? — pyeti e çuditur gruaja.

— Sepse... edhe ju jeni aq të lodhur... sidoqoftë unë po dal! — dhe u kthye për të ikur.

— Prit pak! — u dëgjua prapa saj zëri i një burri. Vajza u drodh. U ndal në çast dhe u kthye. Tani të gjithë po e vështronin, madje edhe ai me shall në qafë e kishte lënë gazetën dhe po e shikonte me kureshtje.

Artisti i popullit S. buzëqeshi plot dashamirësi.

— Moj bijë, ç'bën kështu? Ne vërtet jemi të lodhur, por ty do të të dëgjojmë deri në fund. Kjo është detyra jonë — dhe u kthye nga të tjerët. Ata tundën kokën dhe buzëqeshën. Edhe buzëqeshja e gruas së shëndoshë vajzës tani iu duk e singërtë.

Ai vazhdoi:

— Si të quajnë?

— Safete, por më thërrasin Safo.

— Safo? Emër i bukur. A e di kush ka qenë Safoja?

— E di — tha vajza. — Por nëna, që më thirri e para Safo, nuk e dinte kush qe, përndryshe s'do të më thërriste ashtu.

— Përse vallë? — u çudit ai.

Vajza buzëqeshi:

— Nëna është fanatike, dashurinë e quan turp e Safo, sepse i këndoi dashurisë, u bë e njohur...

Një buzëqeshje tjetër përshkoi fytyrat e gjithë anëtarëve. Kjo vajzë nga provinca kishte diçka të vetën. Ndoshta të shprehurit e çiltër, shikimin e natyrshëm pa frikë, apo diçka tjetër, që nuk e panë te të tjerët atë ditë. E pra, s'ishte e bukur. Një vajzë e thjeshtë krahine, me dy gërsheta të gjatë e të zez, me fustan të thjeshtë.

— Nga je? — e pyeti gruaja.

— Nga K... — u përgjegj vajza.



— Paske ardhur nga malet e largëta. Dhe ke qejf të bëhesh aktore? Do të hysh në grupin e estradës së qytetit?

— Pse në estradë? Ne vërtet s'kemi theatër në qytetin tonë, por do ta kemi së shpejti. Kështu thotë Aliu.

— Kush është Aliu?

— Im vëlla. Është sekretar i Komitetit të Rinisë. Ai më nguci të vija këtu, porsa mora maturën. Por, ndoshta kam bërë gabim...

— E pse gabim? — ndërhyri artisti i popullit.  
— Ke bërë shumë mirë.

— Sidoqoftë... unë e ndjej... — tha vajza dhe i shpëtuan lotët.

— Qetësohu! — i tha gruaja. — Një malësore si ti është turp të qajë. Po sikur të ishte Aliu këtu e të të shikonte?

— Ah, sikur të ishte ai! Por u nis me ekip... — tha vajza dhe fshiu lotët. Këtë çast gruaja e komisionit iu duk shumë e mirë.

— Fillo tani, — vazhdoi gruaja — fillo nga monologu që ke përgatitur.

Safetja, së cilës ende s'i kishte ikur emocioni, filloi monologun e Lokes, nga akti IV i dramës «Toka jonë», kur fshatarët kanë dalë të kërkojnë Tuç Makun, vrasësin e të birit.

«Natë, o natë! Sa e errët po më dukesh sonte!...»

Në mënyrë të natyrshme sytë i ktheu nga dritarja, dorën e djathtë e vuri te gusha. Trupi i dridhej, zëri i dilte i çiltër dhe humbte diku larg, prapa dritares, së bashku me shikimin e saj.

Anëtarët e komisionit në fillim buzëqeshën, pas-taj u bënë seriozë dhe shikuan vajzën plot interesim.

— Ç'qëndrim i natyrshëm! Ç'forcë ndjenjash! —  
i tha njëri nga anëtarët tjetrit me zë të ulët.

— Ajo e jeton pjesën — vërejtji gruaja e re.

Dhe vërtet, Safoja kishte harruar se gjendej në sallën e provimit dhe kishte fluturuar diku larg, andej nga fshatrat e Bregut të Matës.

— Po më duket sikur vërtet është natë — tha njëri.

— Dhe fustani i vajzës, si xhubletë e zezë malësoreje, si xhubleta e Lokes — u përgjegj ai me shall në qafë.

Vajza mbaroi dhe për një çast ndenji ashtu siç ishte e sjellë nga dritarja. Pastaj u kujtua se ku ndodhej dhe u kthye nga komisioni duke buzëqeshur, si e zënë në faj.

— Mirë! — foli gruaja. — Megjithëse lotët i teprove një çikë.

— Sidoqoftë, ajo qan! — tha Safoja kokulur. — Lokja është nënë!

— Tani recito vjershën që ke përgatitur.

— Vajza shikoi artistin e popullit S, dhe, kur pa se ai e nxiste me shikimin atëror, filloi:

«...Deri n'dekë besnik ke  
s'thohet

rronte n'Tule'i padishah...»

— Mbreti i Tulës, Gëte — u tha ai shokëve, megjithëse të tjerët e dinin këtë.

Tek recitonte, pa britma e pa lëvizje duarsh, që janë aq të zakonshme për recituesit, Safoja dukej si një plakë rapsode, e cila në një dasmë fshati u tregon të rinjve historinë e mbretit të Tulës. Recitimi më tepër tingëllonte si këngë, si një këngë e lashtë.

Burri me shall në qafë u interesua më tepër për

recitimin dhe, posa mbaroi vajza, pa pritur të tjerët,  
i tha:

— Shumë mirë, vajzë. Tani, të lutem, na këndo  
një këngë.

— E dija! — tha vajza me keqardhje.

— Çfarë dije?

— Se do të më kërkonit këngë. Unë asnjë këngë  
s'di deri në fund.

— S'ka gjë, s'ka gjë. Ne s'ta kërkujmë të gjithë,  
ti këndoje aq sa di!

Vajzës iu kujtua kënga e Zekë Jakinit, një këngë  
e lashtë trimërie; sëpaku atë e dinte më gjatë se të  
tjerat. Dhe ia filloi:

«...Krisi pushka, gjëmoi deti

Zek Jakini fort gajreti,

fort gajreti e sa mirë qiti...»

Zërin e kishte të ëmbël, por pak të fortë.

— Mjafton me kaq.

— Ju falemnderit! Më falni!... unë nuk... — bel-  
bëzoi vajza me turp, por gruaja e ndërpreu.

— S'ka gjë. Sidoqoftë, ti je tepër e re për rolet  
që ke qejf.

Vajza i kuptoi keq këto fjalë e tha:

— Atëhere, e humba davanë? E dija unë...

— Kush të tha se e humbe? Eja nesër dhe do të  
marrësh vesh në fitove, a humbe.

— Nesër? Në ç'orë?

— Kur të duash! Edhe në orën tetë.

Vajza tundi kokën.

— S'mundem. Nesër në orën gjashtë të mëngje-  
zit nisem për në K.

— Po ti rri nesër — tha ai me shall.

Vajza buzëqeshi.

— Po të rri nesër, autobusi tjetër niset pas tri ditësh. Jo, jo, do të nisem.

— Të bëjmë ne telegram për përfundimin. Na lërë adresën — i tha gruaja.

— Sa keq! A s'mundet tani, sëpaku pasdite? Mund të vijë kur të dëshëroni, edhe në darkë...

— S'mundet — u përgjegj artisti i popullit S.  
— Komisioni mblidhet sonte. Por, a e di çfarë? Ti the se autobusi niset në orën gjashtë. Megjithëse qenka herët, ne po dërgojmë një njeri tek agjencia të të lajmërojë. Të siguroj se do ta dërgojmë patjetër! Mirë?

— Po a do të më njohë? — tha vajza.

— Do të të njohë, patjetër.

Të nesërmen vajza priti më kot te dera e autobusit. Askush nuk erdhi. Pasagjerët kishin hyrë të gjithë brenda. Hyri edhe shoferi dhe, pasi ndezi motorin, i tha vajzës:

— Do të futesh, apo ta mbyll derën!

— Ja, tani — tha vajza me keqardhje dhe mendoj: «E paskam humbur provimin. Ata s'dërguan njeri që të mos tronditem».

— Safo! — dëgjoi një zë në çastin kur po ngjitej në maqinë.

Një e dredhur ia përshkoi trupin kur ktheu kokën. Para saj ishte artisti i popullit S.

— Mirë mëngjez! U vonova një çikë, por kështu e kemi ne pleqtë.

Vajza s'fliste. Priste atë fjalën e madhe, për të cilën mbrëmë s'kishte mbyllur sy. Artisti e kuptoi e ia tha në një mënyrë të bukur, atërore:

— Meqë po nisesh, udhë e mbarë dhe mirë u paf-

shim në 15 shtator, në Institut, kolegja ime e ardhshme.

Pasagjerët kishin nxjerrë kokën nga dritarja e autobusit dhe vështronin. Edhe shoferi, mbështetur me të dyja duart në timon, shikonte vajzën e re, e cila përqafonte atë burrë të thinjur.

## MIRA

Kishim një nxënëse në klasën e tretë A; e quajnin Mira. Të gjithë ne, mësuesit, ishim të një mendimi se prindërit i kishin gjetur emrin më të përshtatshëm.

Mira ishte vajzë e thjeshtë dhe ne u çuditëm kur, papritmas, nisi të vishej më mirë, dua të them të ndiqte një çikë modën. Ndërroi modelin e të krehurit të flokëve, preu gërshetin dhe filloi t'i mbante flokët shkurt. Bleu një triko vishnjë, një fund terital, ndërsa këpucëve u shtoi një gisht takë. Është për t'u çuditur, po kryesisht në klasën e tretë të vajzat ngjasin ndryshime të tilla. Prindërit «e kujdesshëm» mendojnë se vajza u rrit dhe se duhet menduar për fatin e saj. Dhe veprojnë në këtë mënyrë, sikur duan t'u thonë kandidatëve për dhëndurë: «Shikoni vajzën time... Po ju pëlqeu...»

Në dhomën e mësuesve ne diskutuam për Mirën.

— E pati dhe Mira, kaq ishte shkëlqimi i saj! —  
tha Agimi, më skeptiku i kolektivit tonë.

Tomorri, që zakonisht me Agimin shkonte si macja me miun, ia priti:

— Ç'do të thuash me këto fjalë?

— Dua të them këtë, shoku Tomorr; ky ndry-

shim i papritur në veshjen e Mirës paralajmëron fejesën e shpejtë të saj.

— E pse të mos fejohet? Po bëhet 17 vjeçe. Është tamam në moshë. Pastaj, Mira, e mirë është. Gjënë e mirë kush e lë të bjerë përtokë? Edhe unë, po të kisha një djalë...

— Do t'ia jepje Mirën për nuse? Kështu?

— Pikërisht kështu! Ku qëndron e keqja sipas teje? — pyeti i nxehur Tomorri, meqë Agimi qeshi me të madhe.

— E keqja qëndron te fjalët «do t'ia jepja» — u përgjegj Agimi. — Kështu si ti mendon dhe babai i Mirës.

— Pra, e keqja qëndron, sipas teje, te kujdesi i prindit për fatin e fëmijës së vet? Nuk qenka i drejtë ky kujdes i ligjshëm? Kështu thua ti?

Ne të tjerët dëgjonim këtë duel fjalësh e, ndonëse nuk flisnim, secili merrte pjesë në heshtje në bisedë, duke mbajtur me zemër anën e njërit apo të tjetrit. Agimi ndezi një cigare dhe, duke shoqëruar me sy tymin që ngrihej fjollë-fjollë për t'u zhdukur te spiralja e hapur e dritares, u përgjegj:

— Kur ky kujdes bëhet qëllim në vete, atëhere i ngjet kujdesit të një xhambazi për të shitur, apo blerë një kalë.

Nuk mund të bëhet një krahasim i tillë — tha Tomorri i skuqur dhe na u drejtua ne: — Gjykoni edhe ju... ju lutem shumë!

— Sikur të na e zbërtheje krahasimin? — tha Flutura.

— Është fare logjike — foli Agimi. — Ti e dëgjove Tomorrin. Kur qe fjala për moshën e Mirës, ai tha e ka kohën, se është 17 vjeçare. Ndërsa, për të zgjidhur fejesën e saj, u dashka të mendojë vetëm

prindi, sepse Mira qenka «fëmijë». Kur ky mendon kështu, po prindi i Mirës si duhet të mendojë?

Tomorri kërceu:

— Tani po na mban leksion? Po kush ta mohoj, o byrazer, se Mira, apo im bir, nuk duhet të njihen me atë që do të lidhin fatin? Kush të tha?

— Ti e the? — bërtiti Agimi.

— Unë?

— Përmende fatin apo jo? Cili na qenka ai fat? E trokitura e shkuesit? Dhe cila qenka «e njohura me njëri-tjetrin?» Ajo pas fejesës, apo një ditë përpara?

— Njohja e kashtës — foli me zë të ulët Zana. Ndërhyra edhe unë.

— Ti parimisht ke të drejtë, Agim, veç unë nuk kuptoj se ku e sheh të keqen te Mira. Se nisi të vishet mirë?

Agimi shoi cigaren me nervozizëm. U ngrit në këmbë dhe m'u afrua fare pranë.

— Dje në takimin e prindërve erdhi një burrë i veshur mirë, me borsalino, me kuti cigareje prej argjendi. Më pyeti për Mirën.

— Çfarë doni të dini për të? — e pyeta.

— Çdo gjë që ka të bëjë me sjelljen e saj! — u përgjegj ai.

— Jeni prindi i saj? — pyeta.

— Jo, akoma. Ndoshta bëhem nesër! — u përgjegj dhe qeshi.

Agimi na shikoi të gjithë:

— Ja deri ku ka arritur puna. Shkuesit kanë nisur të vijnë te ne për të pyetur mbi cilësinë e mallit që do blejnë.

Ra heshtje e thellë. Raste të tilla na kishin ngjarë dhe ne, ndaj pyeta Agimin:

— Si iu përgjegje? I fole për Mirën?



Agimi më shikoi me keqardhje.

— Ai donte një përgjegje tjetër, po mua nga zemërimi atë çast më dolën vetëm këto fjalë: «Atëherë ejani nesër të pyesni, sepse sot Mira ka prind tjetër».

— Cili ishte ai? — pyeti Flutura.

— E ç'rëndësi ka cili ishte? Ndonjë që ka djalë për të martuar, si Tomorri, apo kunat, si një kolegu ynë. Ju kujtohet se si u bë shkues, vjet dhe fejoj kunatin me një nxënëse?

Tomorri u skuq përsëri dhe nuk po gjente përgjegje të saktë.

— Ti je malinjo! — mundi të thoshte.

— Folë shqip — qeshi Gimi.

— Atëherë po ta them shqip. Ti je keqdashës. Sepse, ndryshe, nuk do ta përmendje rastin e kolegut tonë. Ata u martuan tani. Janë të lumtur. Përse futesh në mes tyre?

— Të lumtur qofshin! Atë dua dhe unë. Nuk po hy në mes tyre aspak. Fola vetëm për kolegun. Ai u bë shkues.

Agimi mori çantën dhe doli duke përplasur derën. Iku në kohën më të mirë, kur ne, të gjithë, vlonim nga dëshira për të shprehur mendimet tona mbi këtë çështje.

Flutura tha:

— Kjo nuk është kaq tragjike sa e bën Agimi. Për më tepër nuk zgjidhet vetëm nga shkolla, siç thotë ai. Ne kemi programet mësimore. Nuk do t'u flasim dhe kundër mblesërirave de? Do të ishte qesharake që unë, duke folur për acidet, të ndërprisja shpjegimin e t'u thoshja nxënëseve: «Vajza të dashura, mos u fejoni me shkuesi...»

— Nuk do bëje keq! — qeshi Zana. — Shkuesia u ngjet acideve gërryese.



Nuk kaloi shumë e Mira u fejuar. «Mori një djalë të shkëlqyeshëm», thanë. Agimi e uroi në orën e mësim:

— Urime, Mira. Më thanë se kishe zgjedhur një djalë të mirë. Po ku u njohët kështu?

Klasa heshti. Mira u skuq dhe uli kokën.

Po kjo ishte një skuqje e përkohshme. Nuk kaloi shumë dhe Mira e hoqi nga trupi drojtjen dhe thjeshtësinë e parë. Tani qeshte, u tregonte shoqeve edhe gazmore, në orët e lira, e shoqet gajaseshin. U tregonte se si kishte arritur të pinte tri shishe birra në lulishte të djelën që kaloi dhe nuk e kishte zënë fare. Ndonjë shoqe e dëgjonte me lakmi e zili.

Ne e njohëm të fejuarin e saj në një mbrëmje vallëzimi. Mira qëndronte në një skaj me të fejuarin që i qeshte fytyra. Sa herë që binte orkestra, ai kërcente me Mirën, ose me shoqet e saj, ndërsa Mira vetëm me të. Asnjë nga shokët e klasës nuk e ftonte për vallëzim. Djemtë druheshin para të fejuarit e kjo e mërzhiste vajzën. Po ja, i ndriti një çast fytyra. Dikush, atje te orkestra, vendosi qetësinë dhe tha se fuqinë e kishin damat. Mira nuk priti më.

Buzëqeshja në fytyrën e dhëndrrit u shua. Ai u vrejti dhe ngacmonte thonjtë me dhëmbë.

Gjithë këtë skenë ne e pamë shumë mirë. Sepse ne, mësuesit kur shkojmë në mbrëmjet e vallëzimit

të nxënësve, zakonisht nuk kërcejmë. E kalojmë duke biseduar, ose duke vështruar vallëzuesit.

Agimi bëri një shaka, që Tomorrit i dogji.

— U zemërua dhëndrri. Vë bast se tani do të tregojë dhëmbët e mprehtë.

Dhe vërtetë kështu ndodhi. Posa mbaroi vallëzimi, ai, diçka i tha me të vrazhdë Mirës, që u skuq e tëra. Ata u ngritën dhe dolën nga salla, Mira e skuqur dhe me kokën ulur, ndërsa ai me një buzëqeshje artificiale në fytyrë.

. . . Një ditë i fejuari erdhi në sallën e mësuesve dhe u drejtua te Tomorri. (Te Agimi nuk shkante kurrë, megjithëse ai ishte mësues kujdestar).

— Profesor, ç'kemi të re nga Mira?

Fliste me konfidencë, si me shokun e vet. Tomorri, pa e shikuar në sy, por duke shfletuar regjistrin, u përgjegj.

— Në klasë nuk mbetet, por nuk është më ajo e para. Mëson pak dhe nuk e ka fort mendjen te shpjegimi.

— Po me sjellje, profesor? — tha ftohtë tjetri.

— Për sjelljen nuk kam ndonjë vërejtje.

I fejuari qeshi i kënaqur.

— Kjo ka rëndësi. Të tjerat rregullohen.

Tomorri ngriti sytë:

— Si rregullohen të tjerat?

— Rregullohen, profesor, mos u mërzit. Do t'i flas unë Mirës. Pastaj, se mos do të vazhdojë universitetin. Maturën do të marrë. . .

— Edhe unë për maturën po flas. Me këtë nuk është në rregull.

— Do t'i flas, profesor.

I fejuari u largua. Agimi, që kishte lënë punën e po dëgjonte, sa u mbyll porta, i tha Tomorrit:

— Tani mund të flemë të qetë për Mirën. I fejuari do t'i flasë. Kështu çdo gjë do të rregullohet.

Askush nuk qeshi. Por ato fjalë, të thëna me keqardhje, na therën në zemër të gjithë. Këtë radhë ai që doli jashtë e përplasi derën ishte Tomorri.

## NJERIU «NËN HIJE»

Njëri nga ne, nuk e di mirë cili qe, kur e pa tek po kalonte oborrin e ofiçinës, ashtu i zbetë, me shpinë pakëz të kërrusur dhe me dosjen e shkresave nën sqetull, tha me shaka:

— Ky njeri duket se gjithë jetën e tij e ka kaluar nën hije. Ndaj, kur del në diell, sikur trembet. Shikojeni si ecën me hapa të shpejtë dhe vështron djathtas e majtas i shqetësuar.

Ne të tjerët qeshëm. Shoku ynë kishte qëlluar në shenjë me këtë nofkë. Kaluan ditë dhe sa herë që ndonjerit i vinin sytë në oborr dhe e shihte atë, thërriste me të madhe:

— Shikoni! Po kalon njeriu «nën hije». Sot diell nuk ka, se e zunë retë. Megjithatë, ai përsëri vrapon i shqetësuar.

E harruam pothuajse emrin e tij. U mësuam ta thërrisnim me emrin e ri. Megjithatë, ai kishte një emër, si gjithë të tjerët. E quanin Rik dhe ishte shef i planit në ndërmarrjen tonë.

Nuk ia përcaktoj dot moshën. Mund të ishte 30, ose 40 vjeçar. Për disa, që bëjnë jetë sedentare dhe kanë fatin të mos venë dhjamë, kjo diferencë moshe prej 10 vjetësh nuk bie shumë në sy. Merren për më

të rinj, megjithëse, po t'i vështrosh mirë dhe nga afër, kanë një zbetësi të çuditshme në fytyrë, një lëkur me një ndriçim të flashkët, shenja këto se atyre u fillon plakja përbrenda.

Riku, për shumicën nga ne, mbahej si njeriu më enigmatik që njihnim, ndoshta sepse e njihnim më pak se çdo njeri tjetër. Ai nuk shoqërohej fare me ne, punëtorët, madje me asnjeri. Rrallë dilte nga zyra, rrallë buzëqeshte, rrallë fliste dhe, kur fliste, ose nuk e ngrinte kokën fare nga shkresat, ose të vështronte, jo në sy, po diku në shpatullën tënde të djathtë. Për çudi, e respektonin, madje e quanin nëpunësin më të përpiktë dhe më të devotshëm të administratës. Dilte i pari në punë dhe ikte nga zyra kur të tjerët ndoshta kishin arritur në shtëpi. Një natë drejtori erdhi të shihte si shkonte puna në turnin e tretë dhe u habit pa masë kur pa dritë në zyrën e Rikut. Mendoi se mos e kishte harruar ndezur, kur kishte ikur dhe turfulloi. Bile u bë gati të niste një njeri e ta sillte nga shtëpia. Mirëpo nga larg nata sillte në oborr zhurmën e kalkulatrices. Drejtori vrapoi në zyrë dhe e gjeti Rikun të zhytur në punë.

— Po ti, ore, ç'bën në mesnatë në zyrë? — e pyeti.

Riku u ngrit, si i zënë në faj. Vështroi supin e djathtë të drejtorit e tha:

— Po punoj, shoku drejtor. . .

— E shoh që punon, po nuk mjaftojnë tetë orët e ditës? Kur erdhe këtu?

— Nuk kam dalë fare sot nga zyra.

— Si është e mundur? Drekën ku e hëngre? Po darkën?

— Mora në klub ca bukë dhe qofte...

Drejtori e shikoi me keqardhje:

— Kaq punë paske?

— Ekonomistja është e sëmurë. Ministria kërkon evidencat për tremujorët. Pastaj kemi projektkërkesat nga importi... Dikush duhet t'i bëjë të gjitha këto..

— Po, po... xhanëm... ke të drejtë — tha nëpër dhëmbë drejtori. — Veç të dërmohesh kështu në punë... Mjaft tani. Lëre për nesër e nami u bëftë!

Riku qeshi ëmbël.

— Për nesër kam punë të tjera në bazë të grafikut mujor...

— Lëri, lëri të gjitha. More, po do flesh sonte, apo jo?

— Natyrisht jo.

— Si, jo? Fare, fare?

— U mësova tani. Nuk është hera e parë... Pastaj, edhe sikur të dua, nuk më merr gjumi kur kam punë pa kryer.

Drejtori doli nga zyra duke tundur kokën me admirim. Urdhëroi rojen e natës të bënte çmos të gjente diku një kafe e t'ia sillte Rikut dhe të mos i tregonte fare se e kishte nga drejtori. Ai e lavdëroi edhe para kolektivit.

Disa ditë me radhë një fletërrufe e madhe, sa një çarçaf, qëndroi e varur në këndin e emulacionit. Drejtorja dhe organizata profesionale falënderonin shokun Rik për punën e tij vetmohuese.

Megjithatë diçka nuk shkante te ky njeri. Nuk di përse, po ne, punëtorëve të rinj, na dukej i panatyrshëm në punë, në ecje, në sjellje. Në mbledhjen e organizatës së rinisë e pyetëm një ditë Gimën, ekonomisten që punonte me të.

— Moj Gime, na thuaj ç'njeri është ky Riku? Është vërtet i tillë sa të biesh copë për të?

Gimja tundi kokën mendueshëm:

— Që të mos gënjej, me mua sillet mirë dhe më dihmon, qoftë në punë, qoftë kur kam nevojë të dal ndonjë orë para orarit. Shefi im ka për detyrë të qëndrojë në karrigen e tij për tetë orë pa folur një fjalë. Meqë nuk flet ai, nuk guxojmë të flasim dhe ne, ose flasim me zë të ulët. Herë të tjera, të mërzit me telefonin e tij. Për një ditë merr në telefon me dhjetëra ndërmarrje dhe me secilën bisedon gjysmë ore. Sidomos me NSHN-në e ka mirë punën. Ajo është ndërmarrja më me precedencë, kur është puna për t'i dhënë maqina transporti. Ia jep jashtë radhe. Apo nuk të shkul gazit Riku me shakatë e tij!

— Riku të shkul gazit?

— Riku shakaxhi? — thirrëm njëzëri, se nuk na besohej.

Gimja qeshi.

— Kjo është gjëja më e çuditshme e tij. Ky njeri enigmatik, i heshtur, ky njeri që nuk të shikon kurrë në sy, po në shpatullën e djathtë, shndërrohet papritmas dhe tregon ca gazmore të bukura, sa nuk e mban gazin kur i dëgjon. Veç i tregon shumë rallë, vetëm kur i lutet drejtori.

— Nuk mund ta marr me mend se si mund të bëjë shaka ky njeri «nën hije!» — thashë unë dhe të gjithë qenë të këtij mendimi.

— Ai nuk qesh kurrë, nuk shoqërohet me asnjëri, nuk e shikon kurrë as në klub, as në mbrëmjet tona të dëfrimit dhe qenka shakaxhi? — tha Muharremi.

— E drejtë — u përgjegj Gimja. — Edhe unë ashtu mendoj, po, që ai është i tillë, ky është fakt. Bile nganjëherë drejtori më thotë të dal pak jashtë dhe unë nga zyra e llogarisë dëgjoj gazin me zë prej basi të drejtorit dhe gazin e të tjerëve. Zakonisht, mua më nxjerrin jashtë, kur Riku tregon gazmore ba-



nale. Ju siguroj se i ka të mprehta gazmoret. Një ditë, kur ai po tregonte një gazmore, unë e kisha mendjen te puna dhe nuk e dëgjova. Qeshën të gjithë.

«— Po ti pse nuk qesh? Apo nuk të pëlqen? — më pyeti drejtori.

— Nuk është e kësaj ndërmarrjeje! — ia priti Riku. — Dhe aty për aty tregoi një gazmore tjetër.»

— Ja, të tilla gazmore tregon Riku — përfundoi Gimja. Gazmoret i ruan vetëm për drejtorin. I ka gjetur pikën e dobët. Drejtori është vetë shakaxhi...

Ne, punëtorët e oficinës rrallë shkelim në zyrat e administratës. Sepse çdo nevojë, që kemi, e zgjidhim me furnitorin apo rekuperon. Megjithatë, ne njihemi mirë me të gjithë nëpunësit madje, me disa, kemi lidhur edhe miqësi të ngushtë.

Vetëm me Rikun nuk njihemi, sepse ai nuk bën punë fizike. Është i sëmurë, siç thonë. Por, meqë, sipas fjalëve të Gimes, ai u bë person interesant për ne, bëra çmos që të njihesha nga afër me të. E prita një ditë, kur dilte nga puna. Zakonisht, kur drejtori mungonte, ai dilte vetëm.

Ai doli dhe u drejtua nga porta kryesore me hapin e shpejtë dhe me kokën e kërrusur. Kishte ngritur jakën e xhaketës, sepse binte pak shi dhe nuk kishte çadër. Unë po e prisja te porta e klubit. Sa më kaloi pranë, i thirra:

— Shoku Rik, do të lagesh. Prit pak të pushojë shiu. Eja të pimë një kafe në klub!

Ai u ndal dhe më vështroi shpatullën. Sytë i hapte përgjysmë dhe nën vetullat e trasha e të zeza nuk ia dalloja dot se ç'ngjyrë kishin. M'u duk se u cudit që e ndala. Nuk buzëqeshi fare, vetëm tha:

— Kafe para bukës? Nuk të bën mirë, o djalë!

Më quajti djalë, shenjë kjo se kisha treguar gu-

xim të tepërt që i propozoja të pinim kafe së bashku.

— Nuk dashke kafe? Atëherë një raki. Ajo besoj se shkon para buke! Pastaj kam qef të njihemi...

— Unë nuk pi asnjë lloj pijeje alkoolike. — Kaq tha dhe desh të largohej. Unë, duke bërë buzën në gaz, i thirra:

— Atëhere ju nuk doni të rrini me një puntor?

Po të më pyesin edhe tani, si guxove t'i thuash kështu, nuk di të përgjegjem.

Nuk kisha asnjë arësye ta bëja këtë, nga ana tjetër, unë, zakonisht, jam i matur dhe nuk i fyej njerëzit kot. Di vetëm se u pendova në çast dhe isha gati t'i kërkoja të falur për çdo përgjegje të rëndë që do të më jepte. Rliku ngriu në vënd. «Prit kur të më lëshohet», thashë me vete. Po ai, për çudi, u kthye i zbetë në fytyrë dhe buzëqeshi.

— Si flisni ashtu? Mua as në mend nuk më shkon një gjë e tillë! Si nuk dashkam unë të rri me puntorët? Ju betohem... thashë të vërtetën, unë nuk pi asnjë pije alkoolike! Ma kanë ndaluar doktorët. Po, meqë ju dëshëroni, jam gati ta prish rregullin. Urdhëroni në klub, ju lutem... edhe unë jam shumë... shumë i lumtur të njihem me ju.

Në fillim kujtova se më mori për ndonjë të çmendur apo tekanjuz, të cilit është shumë më mirë t'ia plotësosh dëshirën, se sa ta kundërshtosh. Dhe, të them të drejtën, u skuqa. U bëra gati të sqarohesha në çast, por ai nuk më la kohë, sepse më mori për krahu si një mik të vjetër, megjithëse as emrin nuk ma dinte dhe u drejtua nga banaku. Porositi vetë dy raki.

— Derisa nuk e pini rakinë... më falni... po unë... — desha të ndërhyja.

— As mos e thuaj. Do pimë nga një së bashku

dhe, po të na pëlqejë mezeja, e përsërisim — shtoi ai.

Dhe, që nga ai çast, nuk më la të flisja. Në fillim më pyeti për emrin, familjen, punën që bëja dhe shkollën që kisha, pastaj kaloi te moti dhe prej këtej te vajzat. Sipas tij po rritej një brez i bukur, vajza për t'i pirë në kupë, por... (ai vuri dorën e djathtë mbi flokët, që kishin nisur t'i rralloheshin). S'e vazhdoi, duke më lënë të kuptoja se kishte perënduar rinia e tij tashmë.

— Kam dëgjuar se dini shumë gazmore dhe i tregoni bukur, — i thashë. Ai qeshi me një ki-ki-ki të shplarë.

— Të kanë gënjyer, xhani i vëllait, të kanë gënjyer. Di vërtet ca qyfyre... po i kam dëgjuar nga ju... nga klasa punëtore... ju, po, ju dini gazmore për t'u gajatur... Ju jeni të mrekullueshëm, edhe për punë, edhe për qejfe, ndërsa ne, nëpunësit... ëhë... na mbysin shkresat, burokracia... futemi në guackë e nuk dalim dot...

— Jeni i martuar? — pyeta kot, se kishte nisur të më mërzhitej. Nuk më linte të flisja.

— Ja një pyetje me vend. Nuk jam i martuar, vëlla. Kush më merr mua?

Përse qenkësh pyetje me vënd nuk e kuptova, por nga fundi i bisedës u binda se ky njeri, jo vetëm ishte i panatyrshëm, por dhe pyetja ime në portën e klubit e kishte trembur pa masë. Ai vërtet nuk i donte punëtorët, sepse, po t'i donte, nuk kishte pse t'i kishte frikë. E, që i kishte frikë, dukej, sepse bënte, ç'bënte dhe ngrinte në qiell punëtorët duke ulur përtokë nëpunësit e administratës. Dhe e te-proi aq shumë, sa më erdhi ndoht prej tij.

— Nuk është e vërtetë ajo që thoni — nuk du-

rova unë. — Edhe nëpunësit bëjnë një punë po aq të nevojshme dhe të dobishme sa ne, punëtorët.

— Po burokratët? Të lutem shumë! — ndërhyri ai dhe qeshi.

— Unë po flas për nëpunësit e administratës në përgjithësi, jo për burokratët. Ç'hyjnë ata në këtë bisedë? Apo mos e konsideroni veten të tillë?

— Po, thuaj ç'të duash, punëtorët janë pararoja...

I dredhoi bisedës si ngjala. U ngrita të paguaj. Më kapi dorën.

— Të lutem, mos më fyej, të lutem shumë...

— Unë të ftova! — i thashë.

— E di dhe nuk e harroj kurrë këtë nder të madh që më bëre, po sot e kam radhën unë. I fitoj lekët me më pak djersë, siç thonë për ne, nëpunësit...

— Edhe kjo nuk është e vërtetë — bërtita.

— Sidoqoftë e kam radhën unë — shtoi ai, pa i vënë veshin asaj që thashë.

— Derisa i përkas klasës hegjemone, nuk duhet ta kesh ti radhën. — Këtë herë isha i ndërgjegjshëm për shakanë pa kripë. Ai nuk do ta kuptonte. Dhe vërtet e mori seriozisht. Heshti.

Pagova i penduar që e ftova, i bindur se kjo ishte hera e fundit që bëja një marrëzi të tillë, por deri diku i gëzuar se doli ashtu si mendoja. Njeri «nën hije»...

## PROVIM NË KORRIDORET E BARDHA

Atë e nxorën nga salla e kinemasë, ashtu thjesht. Filmi u ndërpre, dritat u ndezën dhe atë çast nga galeria u dëgjua një zë:

— Mjekja Valdet të dalë, se e presin në spital!

Valdeti u ngrit dhe buzëqeshi, si e zënë në faj, tek dëgjonte spektatorët që pëshpëritnin.

Përjashta binte shi, por shoferi e kishte afruar maqinën aq pranë portës, sa mjaftonte një hap të futeshe brenda e të rrije në kolltukun e butë.

— E, Zef, ç'kemi? — e pyeti vajza, kur maqina u nis.

— S'e di, por më duket se apendicit, diçka si ky më zuri veshi në poliklinikë! Kishte dhembje të mëdha. Përpëlitej në maqinë, sa të vinte keq!

— Burrë apo grua?

— Burrë plak. Mësues pensionist!

— Mjekun e lajmëruat? — vazhdoi vajza.

Shoferi nuk u përgjegj përnjëherësh. Fshiu xhamin e lagur të maqinës, pastaj shtoi ngadalë:

— I shkova dy herë, por nuk e gjeta në shtëpi.

Vajza hapi sytë e çuditur:

— E si do t'ia bëjmë?

— U pa puna! Do t'ju çoj në spital, pastaj po

kthehem edhe një herë. Ndërkaq ora do të shkojë vonë, kështu që asnjë kafene s'do të jetë e çelur! Mjeku s'para shkon në kafene, por helbete, mund të ketë shkuar me shokë — tha Zefi e qeshi.

— Mos folë ashtu! — e qortoi vajza, por me të butë, sepse edhe ajo buzëqeshi pa dashje. Ajo kishte dëgjuar se mjeku çoku kishte filluar të pinte ndonjë gotë tani, që po i afrohej pleqërisë.

— E pse të mos flas! — vazhdoi shoferi. — Shyqyr që kam me kë të ndërroj dy llafe. S'i thonë shaka të rrish tërë ditën në timon. Pastaj, ai e kreu me nder detyrën. Fëmijët i rriti, u dha shkollë, asistentja i erdhi tani, kot që nuk del në pension.

— Ka kohë për pension, është ende i fortë. Mjekë si ai, i kemi të rrallë. Ti e di më mirë, se ke punuar kaq vjet me të. Apo jo?

— S'them që jo. Gruan time ai e shpëtoi nga ulçera. Por tani s'është më vetëm, erdhe edhe ti.

— Unë vetëm gjashtë muaj kam. Akoma s'kam bërë operacionin e parë.

— Por do ta bësh! Gjithnjë asistente s'ke për të ndenjtur.

Ai heshti një çast. Pastaj se ç'iu kujtua dhe shtoi:

— A e di çfarë? Mos ma vërë veshin që të flas me «ti». S'u mësova që s'u mësova t'u flas të tjerëve me «ju».

Valdeti qeshi. Vërtet që s'e kishte dëgjuar Zefin t'i drejtohej ndonjëherë në shumës.

— Jo, Zef! Unë jam vajza jote! As më ka shkuar ndër mend një gjë e tillë. Ti, veç, mos më lërë të kthehem natën vonë në këmbë nga operacioni, pa më thirr me «ti» sa herë të duash.

— S'e paske harruar natën e Vitit të ri! Epo ne zbatojmë urdhërat, moj doktoreshë.

Valdeti qeshi përsëri. Iu kujtua nata e Vitit të ri, kur e thërritën në operacion para mesnate. Qe shuar drita gjatë operacionit dhe ajo me mjekun e pritën Vitin e ri në errësirë. Atë natë, pas operacionit, ishte kthyer në shtëpi më këmbë, sepse shoferin e kishin urdhëruar të nisej urgjent për në një fshat.

Ndërkaq arritën në spital. Valdeti doli nga maqina.

— Zef, vrapo edhe një herë te mjeku — i tha shoferit dhe u fut brenda.

Në paradhomën e sallës së operacionit ishte shtrirë një burrë thatim, i veshur me një palë bizhama të blerta. Kishte dhembje dhe të prera.

Kryeinfermieri i dha fletën e laboratorit.

— 13.000 leukocite! Qenka keq!

— Sikur ta shohësh edhe ti, doktoreshë!

— Po e shoh, megjithëse diagnoza e klinikës paska dalë.

Valdeti veshi bluzën e bardhë dhe iu afrua të sëmurit. Por, kur e vështroi në fytyrë, duart iu drodhën dhe u skuq. Përpara saj qëndronte mësuesi i fillores, mësuesi i fshatit, ai që e kishte mësuar për katër vjet me radhë. Ai ishte kujdesur t'i delte bursa jetimes së vogël. Mësuesi i shkruante vazhdimisht edhe atëhere kur ajo ndodhej në një qytet të madh të një vendi të huaj, ku studjonte për mjekje.

— Më... mësuesi im! Ju jeni? — belbëzoi vajza me ngashërim.

I sëmuri, një burrë rreth të gjashtëdhjetave, me një ballë të gjerë, me flokë krejt të thinjur, çeli me mundim sytë dhe e vështroi vajzën. Kur e njohu, buzëqeshi me zor.

— Valdet, bija ime!.. — dhe e zunë përsëri dhembjet. Përsëri desh të villo, por siç duket tanimë

stomaku s'kishte brenda asgjë. Gogësi dy-tri herë. Gogësima ia shtoi dhembjen.

Valdetit iu mbushën sytë me lot. Ato fjalë «Valdet, bija ime!» iu dukën si qortim. Kishte disa vjet pa e parë. Ishte kthyer nga universiteti si mjeke dhe s'kishte shkuar në fshat të takonte mësuesin e saj, që e kishte dashur aq shumë.

I kapi dorën mësuesit dhe ia shtrëngoi fort. Mësuesi u përmend. E falënderoi me sy.

— Mos u bëni merak! Dhembjet për pak do t'ju kalojnë.

I preku barkun. E kishte të fortë. Çdo prekje i shkaktonte mësuesit dhembje të mëdha. Shenja të një apendiciti akut. Edhe analiza e urinës fliste qartë.

— Merr në telefon familjen e mjekut dhe pyet nëse është nisur për në spital! — urdhëroi infermieren e narkozës.

Mësuesi i dëgjoi ato fjalë dhe pyeti me zë të mekur:

— Pse, nuk do të më operosh ti, Valdet?

Vajza përsëri u skuq.

— Unë s'kam filluar të bëj vetë operacione. Jam stazhante ende. Duhet të kalojë së paku një vit.

— E unë kisha aq dëshirë të më bëje ti! Kur të pashë që hyre, m'u kujtua kur ishe e vogël...

— Mos flisni, i dashur mësues! — Mjekes përsëri iu mbushën sytë me lot. Iu kujtua dita kur i vdiq e ëma. Mësuesi e kishte marrë atë natë në shtëpi vogëlushen tetëvjeçare, nxënësen e klasës së dytë. Ajo tashmë kishte mbetur vetëm. Jetoj një javë në shkollë, te mësuesi, derisa e mori gjyshja. Por fshati i gjyshes nuk kishte shkollë dhe vajza bënte një orë rrugë për të vazhduar mësimet. Mësuesi i thoshte vazhdimisht.



— «Ç'do të bëhesh ti, Valdet?

E vajza përgjegjej:

— Daktoreshë!»

Dhe mjeke u bë.

Infermierja hyri e alarmuar:

— Në telefon më thanë se mjeku ka një orë që është nisur në lokalitetin B. Atje ka ndodhur një aksident automobilistik. Ndoshta sonte nuk vjen!

— Siii?! — bërtiti Valdeti dhe u zbeh. — Po tani?

Kryeinfermieri dhe të tre infermierët e vështrojnë si të ngrirë. Edhe mësuesi nuk rënkoj ato çaste. Valdetit iu duk sikur qielli i ra në kokë. Po të mos operohej tani, mësuesi mund të vdiste. E ajo, vetë, s'kishte bërë kurrë operacion. Kishte marrë pjesë në shumë operacione, por është ndryshe të operosh vetë. Është si në farkë: njëri mban darën, por hekurin e rreh dhe i jep formë një tjetër.

Si t'ia bënte? Vështroi mësuesin. Edhe ai po e vështronte. Ata zhvilluan një bisedë me sy.

— Ke frikë — pyeti mësuesi.

— Disi! S'kam bërë ndonjëherë.

— S'ka gjë! Provo me mua!

— S'po guxoj!

— Ndërsa unë po. Kam besim te ti. Ke qënë nxënëse e mirë.

— Megjithatë, po sikur...

— Po sikur mjeku të mos vijë? Jepi, Valdet! Mos më korit!

— Vajzën e mbuluan djersët. Ngriti kokën lart dhe urdhëroi pa vështuar asnjërin në sy:

— Dërgojeni në sallë!

Infermierët shikuan njëri-tjetrim. Kryeinfermieri iu afrua dhe e pyeti:

— Do ta bëni ju operacionin?

— Pregatisni sallën! Ti do të asistosh! — i tha mjekja. Dhe çdo gjë pastaj u zhvillua në heshtje.

Valdeti lau duart, infermierja i veshi dorezat e llastikut, i vuri maskën. Dhe ajo, me duart që i dridheshin, ndjeu, për të parën herë në jetën e saj, emociione të jashtzakonshme. Vërtet kishte përpara një operacion jo shumë të rëndë, por ai ishte i tillë për kirurgët me përvojë e jo për një stazhante, që s'kishte veçse gjashtë muaj që qe ndarë me auditorin e universitetit. Pastaj apendiciti ishte akut, dhembjet, sipas kartelës, kishin filluar që ditën e shkuar, pra kishin kaluar 24 orë... Po sikur?... Oh, jo, jo...

Mësuesit porsa i kishin vënë maskën e narkozës, por kjo efektin akoma s'e kishte bërë. Valdeti e shikoi edhe një herë. Sytë e mësuesit përsëri thoshin:

«Mos ki frikë, Valdet! Me guxim!»

Vajza puliti sytë dhe tundi kokën. Vështroi dorën e lidhur te shtrati dhe gati desh ta zinte atë dorë plot rrudha, por u kujtua se ishte me doreza. Infermierët e shikonin në sy. Kryeinfermieri tani qëndronte në vendin ku ajo kishte qënduar për gjashtë muaj. Edhe për të ishte një rast i vështirë. Zakonisht, para se të vinte Valdeti, mjeku thërriste për të asistuar mjekun patolog.

— Fillojmë? — tha Valdeti.

Kryeinfermieri tundi kokën.

Filluan. Valdetit i dukej si në provim. Plagën e hapi shumë të vogël, aq sa e hapte edhe mjeku. Dhe filloi të punonte me gishta në atë skutë të vogël, të errët, ku fshihej apendiksi i mësuesit të saj.

Kur mbaroi, iu prenë fuqitë. Shkoi, duke u lëkundur, deri në dhomën e zhveshjes. Ishte qull në

djersë. Shkoi në lavaman, por nuk piu ujë. Futi kokën nën rubinetë dhe la që uji t'i përshkonte qafën e t'i derdhej në faqe, në qafë. Kishte kryer operacionin e parë, provimin e parë në jetën e mjekut. Ishte e lumtur, por kishte ende frikë. Si do të bëhej i sëmuri? Po mjeku ç'do t'i thoshte. Vështroi nga dritarja. Shiu kishte pushuar. Ora e qytetit po i afrohej dymbëdhjetës. Operacioni kishte zgjatur dyzet e pesë minuta.

— A ta thërrasim shoferin? — pyeti kryeinfermieri.

— Përse?

— T'ju çojë në shtëpi. Është mesnatë.

— Thërriteni dhe shkoni ju. Natën e mirë! — tha vajza.

Ai e kuptoi se nuk i duhej folur më. Për të, sonte, nuk kishte gjumë.

— Natën e mirë, doktoreshë! — tha e në zërin e tij këtë herë kishte më respekt se kurrë.

Narkoza i doli pas një ore, por mësuesin e kishte zënë gjumi. Vonë, aty nga mëngjezi, i erdhën të vjellat.

Valdeti i qëndronte mbi krye dhe dorën e mësuesit e mbante në të sajën.

Zbardhi. Të sëmurët e pavionit u zgjuan një nga një. Kur panë mjeken bri të operuarit, u ngritën në heshtje nga shtrati dhe dolën në korridor. Ata që s'mund të lëviznin, vështronin me habi. Ku ta dinin ata se mjekja kishte bërë operacionin e parë! Ata kujtonin se i sëmuri ishte shumë rëndë.

Mësuesi hapi sytë. Kur pa Valdetin, qeshi dhe i shtrëngoi dorën.

— E, të thashë se do të kalojë mirë! Tani s'kam

dhembje veç ca të vjella. E ti kishe frikë.... buda-  
llaqe.

Valdeti sa s'po hidhej nga gëzimi.

— Pra, jeni mirë? Nuk ndjeni më dhembje?

— Jo, pra, jam krejt mirë!

Vajza i mori dorën e filloi t'ia puthte me forcë, një, dy herë... Dikush e kapi për supi. Ktheu kokën dhe menjëherë u ngrit në këmbë, si një nxënëse e zënë në faj.

— Ç'e puth ashtu?

— E... e kam mësuesin tim të fillores — mundi t'i thoshte vajza mjekut të vjetër.

— Shko poshtë në mensë, se të presin infermierët e pavionit — tha mjeku me sy që i shkëlqenin.

Vajza u çudit:

— Mua më presin?!

— Ke bërë operacionin e parë. Duhet të na qerasësh! S'e di ligjin e kirurgjisë?

## MALESORI I ÇUDITSHËM

Atë ditë të diel unë nuk do ta harroj kurrë. Ajo ka mbetur në kujtesën time si një relikë e çmuar. kujtimi më i bukur i fëmijnisë sime.

Kisha një muaj që punoja si çirak te një pastaçer, tek usta Jani, një burrë i shkurtër, pa flokë dhe me një fytyrë rrumbullake e të ndritshme, sikur ta kishte lyer me vaj. Me mua u tregua i rreptë që në fillim, po ama si mjeshtër nuk ia gjeje shokun. Pastat dhe ëmbëlsirat ai i qëndiste për merak. Vetëm t'i shihje në vitrinë, të shtynin në ngasje. Si i bënte, unë nuk e dija, sepse isha çirak dyqani. Ai kishte një çirak tjetër, Gacin, një djalosh rreth të njëzetave, që e merrte punën në mbrëmje, kur unë, pasi pastroja dyshemenë dhe tryezat, ikja për në shtëpi. Usta Jani dhe Gaci punonin pastaj gjithë natën për të pregatitur pastat. Unë vija në mëngjes dhe nuk gjeja as njërin, as tjetrin. Merrja çelësin në shtëpinë e ustait dhe hapja dyqanin. Ishte puna më e rëndë e ditës. Pastroja, çoja tepsitë e gurabieve në furrën e usta Pistolit dhe rrija e prisja aty derisa të piqeshin. Pastaj kthehesha dhe pastat, që m'i kishin lënë mbi banak, i vendosja në pjata porcelani gjithë dredha e vizatime të çuditshme. Duhej t'i vendosja pastat si-

pas udhëzimit të ustait, gjashtë pasta në një pjatë dhe të gjitha të ndryshme, që, kur klienti ulej në tryezë, të mos kishte nevojë për porosi. Unë duhej t'i çoja një pjatë dhe ai pastaj të zgjidhte cilën të donte. Mund të hante një ose të gjitha, kjo ishte puna e tij. Mjafton të paguante një lek për çdo copë. Ishte një marifet i ustait ky. Sepse, kur i çoje pjatën plot, klienti ngacmohej për të ngrënë sa më shumë. Apo nuk ishin të ndryshme, ca me krem, me çokollatë, me bajame, me gjalpë.

Në qytetin tonë kishte edhe pastičeri të tjera, madje më të mëdha e më të bukura, në mes të bulevardit. Dyqani ynë ishte i futur në një skutë, në dimër ishte i errët, madje dhe në verë dielli ndriste vetëm pasdreke. Por kishte një pozicion kyç. Ishte pranë kishës së françeskanëve, ndërsa në të majtë kishte një rrugicë pa krye, në fund të së cilës gjendej furra e usta Pistolit. Gjithë javën klientë kishte pak, ca të rinj apo çifte që nuk donin të binin në sy, ca familjarë që porositnin ëmbëlsira për shtëpi, kurse të dielave puna vlonte. Andej kalonin gjithë besimtarët, që shkonin në meshë dhe, kur ktheheshin për të filluar shëtitjet tradicionale në bulevardin e qytetit tonë, ndaleshin në dyqan dhe hanin pasta.

Të kthehemi tani tek ajo ditë. Ishte e diel, ora dhjetë. Në kishë mesha kishte filluar dhe do të zgjaste dy orë. Pra pas dy orëve unë do kisha gjuar në tryezën e fundit. Dyqani kishte formën e gërmës L. Dhe nuk kishte banak fare. Dritaret shërbenin edhe si vitrina. Klientit ia servirnim pastat nga punishtja, që gjendej në fund të dyqanit. Kur punishtja boshatisej, shisnim pjatat e vitrinave. Këtë

marifet ustai e përdorte që klienti të kishte përshtypjen se po i jepnim pasta të porsagatuara.

Çifti, që gjendej tani në dyqan, ishte i përditshëm. Së paku, gjatë kohës që shërbeja unë, vinte çdo mëngjez. Flisnin me zë të ulët dhe unë i lija të qetë. Madje edhe kur iknin, nuk u viheshja pas. Paratë i linin në tryezë dhe nganjëherë me ndonjë bakshish të vogël.

Ishte maj, muaji i sakramendit. Ditë e bukur me diell. Isha ulur në fund të dyqanit, i pastër, me përparëse fringo të re dhe po lexoja Robinsonin që kishte dalë ato ditë. U hap porta (ajo kishte një zile që lajmëronte sa herë hapej) dhe hyri një malësor postribas, i pisët, me një trastë të madhe pas shpine. Ai u nis në kthesën e djathtë, po, kur pa çiftin, ndërroi mendim dhe u ul fare pranë meje. Ishte hera e parë që shikoja një fshatar. Madje, po të mos ulej, do ta merrja për ndonjë lypës, se qyteti ishte mbushur me ta. Por ai u ul dhe unë u afrova.

— Urdhëroni?

— Ku është ustai? — më pyeti.

— Në pazar.

— Kur kthehet?

— Nga dymbëdhjeta. Po ç'të duhet ustai? — e pyeta.

Në të vërtetë të dielave ustai shkonte në pazar për të blerë vezë të freskëta dhe kthehej pikërisht kur dilnin njerëzit nga kisha për të më ndihmuar. Malësori shikonte nga dritarja përtej pjatave me pasta dhe nuk ia përgjegj fare pyetjes sime. Unë u inatosa.

— Nuk bën të rrish në dyqan — i thashë.

— Pse? — më pyeti dhe qeshi.

— Sepse duhet të hash, pa të rrish.

— Qenke i ri? — tha ai dhe qeshi përsëri.

— E ç'të duhet ty? — thashë unë gjithë inat.

— Si të quajnë?

Unë humba durimin. Malësori ishte tuhaf njeri. Unë e pyesja dhe ai, në vend të përgjegjej, më pyeste sërish.

— Shporru, — i thashë — nuk është për ty ky dyqan. Shko te ndonjë hallvaxhi. Atje ka gjëra të lira.

— Këtë të fundit e the mirë — foli malësori. — Po, sidoqoftë, mos u sill kështu me fshatarët. Edhe ne dimë të hamë pasta të mira. Më sill ca dhe të shikosh.

— Ke lekë?

— Po nuk pata, të lë qeleshen peng — qeshi ai dhe vështroi nga dritarja. Atë kohë nga rrugica e usta Pistolit po vinin në drejtim të dyqanit tre karabinierë. Unë hyra në punishte dhe zgjodha një pjatë me pastat më bajate. Kishin pesë ditë dhe ishin bërë gur. «Fshatar hesapi, thashë, ku di ky të dallojë?» Ja çova në tryezë, pa pirun e thikë e pa picetë letre. Në atë kohë hynë në dyqan karabinierët. Zilja trokiti me forcë. Malësori u lëshua në pasta si budalla. E kapi njëren me grusht dhe po e hante, duke i fëlliqur duart me krem. Hante dhe lëpinte gishtat e zinj. Karabinierët hodhën një shikim në dyqan dhe, kur panë malësorin që hante ashtu, pështynë dhe shanë nëpër dhëmbë. Një fjalë e kuptova, «bestia», që do të thoshte shtazë. Pastaj dolën dhe u nisën përsëri nga rrugica e furrtarit. Atëhere malësori ndërroi papritmas. Më thirri e më tha:

— Këto pasta janë bajate, po s'ka gjë. Së paku më sill pirun dhe thikë si gjithë të tjerëve. Nuk të



vjen turp? Njerëz si të gjithë jemi dhe ne, malësorët. Edhe ti bir malësori je.

U skuqta në fytyrë dhe i solla me kokë ulur pirun, thikë e picetë. Dhe malësori, për çudinë time, kapi me dorën e djathtë thikën, me të majtën pirunin dhe hëngri pastën e dytë me një delikatesë të çuditshme. Pastaj fshiu buzët me picetë dhe piu një gotë ujë. Ndërsa bënte këtë dhe qeshte nën mustaqe, unë vrisja mendjen ku e pikasi ky malësor se edhe babai im ishte i tillë, pavarësisht se unë kisha lindur në qytet. Klienti i çuditshëm nuk më la të mendoja më gjatë. Më tha:

— E njeh usta Pistolin?

— Si nuk e njoh? Dy herë në ditë shkoj në dyqanin e tij.

— Mund të shkosh dhe një herë të tretë?

— Përse të shkoj?

— Për mua.

— Kam dyqanin vetëm. Po pse nuk shkon vetë? Ja ku është.

— Sepse janë ata të tre karabinierët — më tha qetë-qetë dhe më shikoi thellë në sy. Unë u shtanga. Malësori po shndërrohej para meje në një njeri misterioz. Dhe kishte diçka të veçantë zëri i tij, që nuk mund ta kundërshtoja. Isha 14 vjeç dhe e quaja veten burrë. Vetëm para tij ndjehesha një fëmijë grin-davec dhe i keq. Kureshtja më tha t'i bindesha.

— Po shkoj. E çfarë t'i them?

— Thuaj se Veliu nuk të sjell qymyr sot. Pyet kur e do një ditë tjetër. Veç gjej ndonjë shkak për të shkuar. Merr ndonjë tepsi me vete.

E shikova si guak dhe bëra si më tha. Para fuurrës sillëshin karabinierët. Në tepsi mora me vete ca pasta bajate dhe, pasi i spënkata me ujë, i çova në fu-

rrë, gjoja për t'i zbutur dhe ngrohur. Kështu veprom shpesh, po natyrisht natën, që të mos shikonin klientët. Karabinierët panë pastat dhe nuk më folën. Hyra në furrë dhe i thashë porosinë usta Pistolit. Ai u drodh, vështroi përtej dyqanit disa herë, pastaj m'u afrua dhe më tha në vesh!

— I thua j se gjithë këtë javë nuk dua qymyr. T'ia shesë Marianit, se kërkon.

Kur u ktheva, gjeta në dyqan një burrë me pardesy dhe me mustaqe spic. Ai vinte shpesh te ne, por, për çudi, megjithëse rrufiste një pjatë pasta, ustai e urrente dhe shante pas tij, kur dilte. «Është i fëlliqur», thoshte. Desha të drejtohesha te malësori, por burri me pardesy më kapi dorën.

— Ku ishe, mistrec? — më shfryu.

— Në furrë isha, po ç'të duhet ty? — u përgjegja me inat.

Burri me pardesy më ra me shuplakë turinjve, sa më nxorrën sytë xixa.

— Çfarë i the Pistolit dhe ç'të tha ai? — pyeti vrazhdë.

Nuk pata kohë të përgjegjesha, sepse në atë çast pranë nesh erdhi fshatari.

— Pse i bjen djalit, or ti? — pyeti me një mal-sorçe të rëndë.

Për habinë time burri me pardesy u bë pulë.

— Më fal, dajë... po u bëra nervoz. Ka dhjetë minuta që kam ardhur dhe ky nuk është. Dua të ha pasta.

— Mos rrej, se tash erdhe — u përgjegj fshatari — dhe mos guxo t'i biesh, se të bij unë pastaj, që ta mbash mend.

Kaq tha dhe shkoi te vendi i vet. Unë me faqe të skuqur i solla pastat njeriut me pardesy dhe shkova

në vendin tim. Vështroja fshatarin dhe atë që më ra.

Edhe ata shikonin njëri-tjetrin. Fshatari serioz dhe i vrazhdë, burri me pardesy, buzëqeshte nën mustaqet si të miut. Qëndruan kështu pa folur derisa mustaqemiu përllau pastat dhe më thirri të paguante. Dësh të më falte tre lekë bakshish, por ia hodha surratit. Ai përsëri qeshi dhe u largua pa shikuar. U drejtua nga bulevardi. Kur u zhduk, vrapova te fshatari dhe i thashë çdo gjë. Ai nuk foli, por kapi barkun me dorë dhe filloi të rënkonte nga dhembja.

— Më bënë keq pastat e tua, or çun — tha. — Ku keni një yzyrhane, se plasa.

Unë, duke më vrarë ndërgjegjja që i kisha dhënë pastat bajate, e çova në banjën që gjendej pas punishes. Atë kohë ranë kambanat e kishës. Pra mesha pas disa minutash do të përfundonte. Dyqani do të mbushesh me klientë. Vrapova të hapja portën në dy kapakë, pastaj më thërriti çifti në qoshe për të paguar. Vajza më mbajti shumë me muhabet. Më pyeti për emrin, për familjen, më premtoi të më jepte libra për të lexuar, shkurt nja 10 minuta të mira. Pastaj më lëshuan. Ndërkohë në dyqan kishte hyrë një italian. Them italian, sepse kishte borsalino dhe flokë të ndarë në mes e të lëpirë nga brilantina. Më foli italisht:

— Garzone, una torta.<sup>1)</sup>

Kërkonte tortë. I solla pjatën dhe ngriva në vend. Në derë po futeshin nja dhjetë karabinierë së bashku me burrin me pardesy. Pushkët i mbanin në duar.

— Ku është malësori? — më pyeti burri me pardesy.

---

1) Garson, një tortë!

Unë kisha harruar fare, se e kisha lënë në banjë. U hutova për një çast, por e mbloodha veten dhe iu përgjegja gjithë inat mustaqemiut:

— Doli... pagoi dhe doli.

— Nga shkoi? Si nuk e pamë? — bërtiti ai.

— Ku di unë nga shkoi? Detyra ime është t'i marr lekët, po nga shkojnë klientët...

Përsëri një shpullë më ndezi faqen, ndërsa karabinierët më kapën për krahësh.

— Gënjen, qen e bir qeni. — Trego, ku u fsheh, se ta mora shpirtin.

I ndrisnin sytë spiunit si të bishës. Do të ma merrte shpirtin vërtet, po të mos ndërhynte vajza atje në fund.

— Iku vërtet, zoti Marian. E pamë ne.

Ishte vajzë e bukur dhe burri me pardesy u zbut. Por, ama, karabinierët nuk më lëshonin.

— Fate una percuisizione?<sup>1)</sup> — thirri një nga karabinierët. Pra, donin të bënin kontroll. Dhe fshatarin do ta gjenin në banjë. M'u dhimbs, por nuk kisha ç'të bëja. Ndoshta ai kishte dalë vërtet, siç tha vajza, por unë nuk e pashë. Pastaj, si do të ikte pa paguar, kur i bëra dhe një shërbim, bile hëngra shputa për shkak të tij? Në djall të venin lekët, veç të shpëtonte nga karabinierët. Ndërhyri italianin me borsalino.

— Cercate il montanaro?<sup>2)</sup> — pyeti.

— Si. Dove e? — u përgjegj një karabinier.<sup>3)</sup>

---

1) Bëni një kontroll!

2) Kërkoni malësorin?

3) Po. Ku është?

— E scappato via... mi pare che e entrato nella chiesa. Ma chi e? Un ladro?<sup>1)</sup>

— Di piu... un comunista... pericolosissimo... Grazie... andiamo, presto...<sup>2)</sup>

Dolën si era. Pas tyre doli çifti e pas çiftit italiani, që më dha bakshish.

Mbeta vetëm. Vrapova në banjë, se mos fshatari ishte akoma aty. U lehtësova. Vërtet kishte ikur. Por, kur po kthehesha, sytë më shkuan në magjen e brumit. E kisha lënë bosh, tani aty ishte diçka e mbështjellë me çarçaf të bardhë. E hapa çarçafin. Ishte thënë që atë ditë çuditë të ndiqnin njëra-tjetrën. Dora më preku trastën e fshatarit dhe brenda trastës ishin rrobet e tij. E njëjta qeleshe e pisët, i njëjti brez, xhamadan, tirq, këmishë.

Si i trullasur dola në dyqan, se ai po mbushej tani. Njerëzit dilnin nga kisha. Për fat atë kohë arriti ustai dhe ne punuam pa folur nja dy orë të mira. Pjatat me pasta boshatiseshin njëra pas tjetrës. Punoja dhe kujtoja ngjarjen. Dhe diçka më sëmbonte. Fshatari kishte ngrënë tri pasta dhe nuk më kishte paguar asnjë. Vërtet kishte lënë rrobet, po ç'më duheshin ato? Në mbrëmje merrja pagën e javës. T'i tregoja apo jo ustait? Po ç'i duheshin atij të gjitha këto? Detyra ime ishte të mos lejoja asnjëri të ikte pa paguar. T'i thosha se i kisha ngrënë unë. Më vinte turp.

Vendosa t'i thosha se i kisha ngrënë dhe të ndalte tre lekë nga shtatë lekët e pagës. Dhe kështu bëra. Usta Jani më vështroi thellë, heshti për një çast, pastaj foli:

---

1) Iku... më duket se hyri në kishë... Po cili është? Një vjedhës?

2) Më shumë... një komunist... shumë i rrezikshëm. Falemnderit... shkojmë shpejt.

— Nuk më besohet t'i kesh ngrënë, po sidoqoftë, të bëfshin mirë.

— Të lutem ndal tre lekë. Nuk jam fëmijë — i thashë. Ai u nxeh.

— Unë nuk të kam ndaluar të hash pasta në dyqan.

— Vërtet më ke dhënë nga pastat që nuk shiten, por këto ishin تازه.

— Mirë, meqë ngul këmbë, urdhëro katër lekët. Desha të largohesha. Kisha marrë dhe trastën e fshatarit me vete. Nuk doja të dinte gjë ustai. Kur më pyeti ç'kisha në trastë, u skuqta nga inati.

— Po deshe shikoje, veç të jesh i sigurt se nuk të kam vjedhur gjë në dyqan — u përgjegja.

Ustai më lëmoi kokën pa folur dhe më tha:

— Shko, djalë, nuk ka nevojë, të besoj dhe mos u sill kaq i egër. Nuk jam aq i keq sa mendon.

Ishte ora dhjetë e mbrëmjes. Po shkoja në shtëpi i lodhur, kur dëgjova tri krisma pushke dhe një thirrje të thekshme. Njerëzit që po shëtisnin akoma, vrapuan nga dyqani i manifaturës, bri xhamisë. Vrapova dhe unë.

Mes një turme kureshtare, i shtrirë përtokë, po jepte shpirt njeriu me pardesy, spiuni. Nuk kishte vdekur akoma, lëvizte buzët dhe dora e djathtë gërryente dheun. Ishte ajo dorë që më kishte goditur dy herë. Në turmë bisedonin me zë të ulët. Spiuni po dilte nga një kafene, e goditën nga një kamionçinë që u zhdruk në kthesë... komunistët...

Kur erdhën karabinierët, turma u shpërnda. Ika dhe unë.

Babait ia tregova të gjitha sa më ngjanë. Ai më ledhatoi. Fjalët e tij qenë këto:

— Fshatarin, kushdo qoftë, bëre mirë që nuk e

padite. Derisa e kërkonin karabinierët, ka qenë njeri i mirë dhe trim. Kurse atë, Marianin, e njoh. Ai ka çuar në burg dhe në litar sa e sa njerëz. E kishte mbushur kupën, o bir. Ia bënë mirë.

Atë natë fjeta keq. Më fanepsej fshatari misterioz, spiuni dhe dora që gërryente dheun.

Të nesërmen në mëngjez, si zakonisht, shkova të merrja çelësin në shtëpi të ustait. Ai doli vetë te shkallët dhe, për çudi, më ftoi të hyja brenda. U binda. Në dhomën e gjumit po më priste fshatari. E njoha menjëherë.

## SHQETËSIMET E PLAKËS

Plakën e zuri gjumi dhe, si zakonisht, filloi të gërhiste me zë të mbytur. Pa në ëndërr fshatin e saj, shtëpinë atje, rrëzë pyllit, dëgjoji edhe lopën, që pëlliti disa herë. Në fillim plaka nuk ia vuri veshin, sepse ishte shumë e lodhur, por, kur lopa përsëriti me ngulm ankesën e saj aq të njohur, ajo u ngrit nga stroma dhe zbriti në oborr. Në fund të tij gjendej kasollja ku mbanin bagëtinë. Tha me mendje se kishin bërë gabim të madh që i hoqën bagëtinë nga bodrumi i shtëpisë dhe i degdisën në kasolle. Plaka hapi derën e kasolles dhe iu afrua Larukës. Lopa ishte shtrirë sa gjerë gjatë në kashtën e grazhdit dhe thërriste sa të këpuste shpirtin. Ishte përsëri barsë dhe priste viçin e shtatë. Plaka i vuri dorën në bark për ta përkëdhelur, po lopa këtë radhë u ngrit dhe pëlliti aq fort... aq fort, saqë plakës i doli gjumi.

Ajo u ngrit këmbëkryq mbi shtrat dhe fërkoji sytë. Ku ishte vallë kështu? Nata sillte tek ajo fishkëllimën e një lokomotive. Asaj iu duk si britmë e kuçedrës së përrallave. Ca maqina zhurmuar poshtë në xhade dhe kaluan njëra pas tjetrës. Dikush thërriste atje larg te moli «Djaaaathtas... djaaaathtas... më pooooshtë... më pooooshtë...», ndërsa dritat e dy pro-



zhektorëve herë pas here kryqëzoheshin pikërisht para dritares. Ato çaste dhoma ndriçohet pakëz dhe hija e plakës zgjatej e stërgjatej në murin përkarshi.

— Ku jam kështu? — thërriti e trembur dhe kërceu nga shtrati. Sustat e shtratit kërcëllitën me zhurmë. Atëhere plaka u kujtua se ku gjendej. U qetësua menjëherë dhe, duke buzëqeshur si me faj, iu afrua komodinës dhe hapi llampadarin. Sa gjë e mirë ky llampadari! Thoshin se në fshat edhe agronomi i kooperativës kishte një të tillë, po plaka nuk e kishte parë. Përse nuk sillnin në dyqanin e fshatit gjëra të tilla, kaq të bukura? Do ta kishte blerë edhe ajo një të tillë që ta vendoste aty, buzë minderit, ku flinte. Plaka i harroi zhurmat, harroi dhe Larukën atje te kassollja dhe u shtri përsëri në shtrat. Po këtë radhë nuk e zuri gjumi. Shikonte tavanin ku varej një poç i bardhë sa një kokë njeriu që plaka tanimë e dinte se ç'ishte. Ai poç ashtu si llampadari ishte gati ta bente dhomën të ndriçonte.

Një ditë më parë kishte ardhur nga fshati. Tani ishte në këtë qytet të madh, tek i biri. Kishte ardhur përgjithnjë të jetonte me të. Kështu e kishin pleqëruar atje në fshat, me plakun e saj. I kishte thënë plaku:

— Ti shko te Gjergji! Shko të jetosh me të. Nuk është mirë ta lësh vetëm.

— Po ti? Si do të jetosh? Kush do të të shërbejë, kush do të ta sjellë kafënë në mëngjez? — i kishte thënë ajo.

— Më shërben nusja e Markut. Ajo është aq e mirë! Nuk e quan gjë të rëndë se i sjell plakut një kafe apo i bën ndonjë shërbim.»

Dhe plaka u nis me një trastë me rroba.

— Mos merr asgjë, i ke të gjitha këtu — i kishte thënë Gjergji.

Plaka kishte dy djem. I madhi, Marku, ishte bletërritës i kooperativës, i martuar, me katër fëmijë, ndërsa Gjergji kishte bërë shkollë dhe tani ishte oficer në një anije që shpesh çante detrat. Edhe ai ishte martuar. Porsa i kishte lindur një djalë. Plaka tani do të jetonte këtu që të mos mbetej vetëm nusja, kur i biri të merrte detrat.

Zhurmat nuk kishin ndërmend të pushonin dhe plaka nuk mund të flinte. Kjo pra na qenka dhoma e saj, dhoma ku do të ngryste ditët tani e tutje. I erdhi mall për fshatin, për çdo skutë të shtëpisë, të oborrit, të kasolles së bagëtive e mbi të gjitha për atë qetësinë e butë që mbretëronte atje sidomos në vjeshtë. Plakës iu mbushën sytë me lot, ndërsa lokomotiva, si për inat, lëshoi një tytyyy të zgjatur si shpirt i keq.

«Sonte qenka thënë të rri pa gjumë. Nuk flihet dot me këto zhurma shurdhuese. Njerëzit sonte paskan luajtur mendsh, ia morën gjumin qytetit», mendoi ajo dhe iu kujtua dhoma tjetër ku flinte i biri, nusja dhe Artani i vogël. «Me siguri edhe ata janë zgjuar. Mirë unë, po ç'faj kanë djali dhe nusja që do të dalin në punë porsa të gdhihet? Pastaj Artani, ç'faj ka njomëzaku të rrijë pa gjumë kur ka aq nevojë, që t'i bëhet shtati dy metra si i babait?»

Plaka u ngrit dhe nderi dritën e madhe, atë poçin e bardhë sa një kokë njeriu, që tani, me urdhërin e gishtit të saj, u bë i kuq, madje si në të verdhë, ashtu si dielli kur lindte nga kodra e Sërbit atje në fshat. Hapi derën dhe doli në korridor. Shkoi në majë të gishtërinjve te dera e dhomës ku flinte i biri. Shikoi nga vrima e çelësit. Errësirë. Vuri veshin. Qetësi. Vetëm i biri gërhiste lehtë. E njihte mirë atë gërhitje. I qeshi fytyra dhe u kthye përsëri

në dhomën e saj. U shtri. Qëndroi ashtu gati një orë, madje i mbylli sytë që ta zinte gjumi. Po gjumi ishte arratisur për atë natë. Plaka e bindur u ngrit përfundimisht, veshi fustanin dhe shkoi në kuzhinë.

«Më parë po pi një kafe që të më largojë të keqtë. Nusja e Gjergjit është shumë e mirë, po kafënë nuk di ta pjekë. «Nuk pihet kafeja me sheqer shumë», thotë. Oj, ç'na qenka! Ajo do të më mësojë mua se si u pika? Le ta pijë të hidhur ajo me tim bir. Unë e dua të ëmbël, bile dhe me sheqer në filxhan. Edhe kjo furnella elektrike gjë e mirë shumë. Të tilla kanë sjellë në dyqanin e fshatit, veç nuk i blejnë, se gjoja qenkan të rrezikshme dhe shpenzokan».

Plaka piu kafënë dhe përgatiti mëngjezin për të gjithë.

\*  
\* \* \*

Gjergji dhe nusja po hanin. Plaka në një qoshe kishte marrë në prehër Artanin e vogël dhe po i jepte qumësht me një lugë. Plaka në fillim i kërkoi nuses shishen me biberon, po ajo iu përgjegj se nuk donte ta mësonte djalin me biberon. Plakës iu duk pa vend ky mendim i nuses, po nuk bëri zë. Ishte e matur. E dinte se nuk i duhet përzier nuses në disa gjëra që të jesh gjithnjë vjehërr e dashur.

— O, Gjergj! — tha papritmas. — A keni polic këtu?

Djali dhe nusja ngritën kokën të çuditur.

— Kemi, nënë, si s'kemi. Po pse pyet? — tha i biri.

— E kanë larg zyrën e tyre policët e këtushëm?  
— vazhdoi plaka.

— Këtu afër molos e kanë. Po pse pyet? Ç'të duhen policët?

— Më duhen, si s'më duhen! Ti do të shkosh pastaj në zyrën e tyre dhe do t'u thuash për ata maskarenjtë e mbrëmshëm.

— Për cilët maskarenj, nënë? — Burrë e grua kishin mbetur me lugë në dorë dhe vështronin plakën. Po edhe ajo i shikoi e çuditur.

— Pse, nuk keni dëgjuar gjë mbrëmë?

— Mbrëmë? Jo! Pse, ç'ngjau mbrëmë?

— Si, ore, nuk dëgjuat fare? — Epo, s'keni faj, bijtë e nënës, paskeni qenë të dërmuar fare nga puna.

— Ç'thua kështu, nënë? Unë dje nuk isha fare në anije, se të prita ty, ndërsa Mimoza ka lejen e zakonshme.

Plaka picërroi sytë me inat.

— Ishin ca shoferë e ca të tjerë që e kanë hak burgun. Silleshin vërdallë me maqina, me lokomotivën e trenit duke i rënë asaj tytysë si zë shtrige. Një tjetër ndizte ca drita dhe m'i vërtiste mu në dritare, ndërsa një budalla si ai Prenga i fshatit tonë, bërtiste në kupë të qiellit vetëm katër fjalë: «Djathtas, majtas, më poshtë, më lart...» Dhe vazhduan kështu gjithë natën. Asnjë polic nuk doli t'i ndalonte.

Burrë e grua në fillim shikuan njëri tjetrin, sepse nuk e kuptuan menjëherë. Pastaj papritmas, si ta kishin bërë me fjalë, ia plasën gazit në të njëjtën kohë.

— Ato zhurma vijnë nga porti, nënë — foli nusia. — Në port ngarkohen e zhkarkohen anije pa pushim, ditën e natën.

Gjergji e shikoi të ëmën dhe shtoi:

— Këtu nuk je në fshat, nënë. Ato britma dhe zhurma maqinash do t'i dëgjosh çdo natë.

— Çdo natë? Nuk flenë njerëzit këtu?

— Ndryshe është në qytet, nënë. Këtu fabrikat punojnë edhe natën që të kemi prodhime më shumë, ndërsa anijet duhen ngarkuar edhe natën që të nisen më shpejt atje ku duhet.

Plaka vuri dorën e djathtë në gushë dhe i shikoi ngultas.

— Dhe ju flini me gjithë këtë zhurmë?

— U mësuam. Dy-tri net do ta kesh vështirë dhe ti, pastaj do të mësohesh.

Një ditë, kur po hanin darkë të tre, plaka foli lehtë:

— Gjergj, në ç'orë niset treni për në Laç nesër? Gjergji e shikoi thellë. E kuptoi ç'bluante në mendje e ëma.

— Ka disa trena që nisen çdo ditë. Ai i mëngjezit niset në shtatë. Po ti pse pyet?

— Do të nisem, bir...

— Të nisesh? Po ti nuk ke një javë që erdhe — foli Mimoza.

Ra një heshtje e thellë. Burrë e grua shikuan njëri-tjetrin. Plaka u ngrit nga tryeza dhe shkoi te lavamani që të lante duart. Ishte mësuar të lante duart para dhe mbas buke. Pasi i fshiu mirë e mirë, u ul në divan. Kuzhina kishte aneks të mbuluar me perde, ndaj e përdornin edhe si dhomë pritjeje.

— Kaq shpejt të mori malli për fshatin? — pyeti prapë i biri.

— Edhe për fshatin, edhe për njerëzit që kemi atje, — tha plaka. — Pastaj... me zhurmat nuk po mësohem dot.

— Ama për këtë do të ikësh? — tha i biri.

— Po, Gjergj. Pak të duket?

— Tani e ke pak të vështirë, po më shiko mua. Kur vij në fshat, nuk më zë gjumi nga qetësia. Sepse jam mësuar me zhurmë, këtu, dhe në anije. Edhe ti do të mësohesh.

Plaka heshti një çast, pastaj tha lehtë:

— A kam kohë të mësohem se? Nuk më pret koha mua, o bir. Jam plakë.

— Po edhe të ikësh në këtë mënyrë është turp. Si do t'u thuash babait e Markut? Do të tallen me ty.

— Le të tallen, bir. Do të duroj. Po zhurmën nuk e duroj.

— Ndoshta ka të drejtë. Ashtu është mësuar — tha Mimoza.

— Jo, nuk ka të drejtë. Ajo është e lirë të jetojë ku të dojë, po të ikë nga zhurmat nuk ka të drejtë — i tha së shoqes Gjergji. Pastaj u kthye nga e ëma që tani po thurte triko me shtiza! — Ti erdhe të jetosh me ne. Mos vallë mendon se do të të vëmë të punosh e ne të bëjmë sehir?

Plaka ngriti kokën serioze:

— As në mendje nuk më ka shkuar kjo. Përkundrazi, unë që jam mësuar me punë, këtu nuk po bëj asgjë. Nusja po më llaston.

— Po atëhere? Pse po ikën? Ti erdhe të mbash Artanin, të jesh pranë Mimosës, kur unë të largohem për muaj të tërë. Po lë tët bir e tët nip për zhurmat e molos?

— Ti im bir mbetesh, kudo që të jesh, sado larg, je gjaku im.

— Ama po më lë...

— Jo, bir, nuk po të lë. Po shkoj tek im shoq, në strofkën time. Kurse ti ke tënden. Kështu është

jeta tani. Nuk i mban dot fëmijët. Fluturojnë ata së zogjtë. E ndërtojnë jetën si duan e ku duan.

— Tani unë do të rri vetëm, kur Gjergji të marrë detin — bëri përpjekjen e fundit Mimoza. Plaka qeshi.

— Eja te ne, në fshat, kur të shkojë Gjergji në det.

— Po kam punën.

— Eee, të mos ishe martuar atëhere. Kot flet, nuse. Më është mbushur mendja top për t'u nisur.

— Atëhere të mos kishe ardhur fare — tha i biri me zemërim. Plaka qeshi përsëri.

— Nuk e thua me zemër, o bir. Flet nga inati, e di. Fale nënën! Kaq di, kaq bën ajo. Zemrat i kemi plot me njëri-tjetrin. Kjo ka rëndësi. Pa sado larg që të jemi, në vendin tonë jemi. Sikur të të thosha ta lije punën që ke e të vije të jetoje në fshat, pranë prindërve, ti nuk do ta bëje, jo ngaqë s'na do, po ngaqë i jep më tepër vendit këtu. Ti e do me shpirt këtë vend ku të lidh puna. Pra mos më pengo edhe mua të shkoj aty ku më lidhin 70 vjet pune e kujtime. Të isha e vetme, hajde se shkon, po atje shtëpinë e kam plot. Mos m'u zemëroni. Kështu e kanë plakat, kur kanë plakun gjallë.

— T'i themi dhe babait të vijë. Kemi vend këtu...

— Natën e mirë! Po shkoj të fle. Më jep ilaçin, nuse, që të më zërë gjumi — tha plaka dhe, pasi i puthi që të dy në ballë, u nis në dhomën e saj. Piu ilaçin dhe u shtri. Nisën t'i mbylleshin kapakët.

— Sa çudi! Një hape kaq e vogël të sjell gjumin menjëherë. Me çfarë e kanë sajuar vallë? Në qytet ua kanë gjetur ilaçin të gjithave.

Atë e zuri një gjumë i thellë. Pa në ëndërr fshatin.

Të nesërmen e përcollën deri në stacion. Mimoza

i tundte doçkën Artanit të vogël, që s'kuptonte gjë. Plaka i vështronte serioze nga dritarja e vagonit.

Treni lëshoi britmën e vet të njohur dhe nisi të lëvizte. Plaka hodhi shikimin te porti ku ca vinça të stërmëdhënj silleshin rreth një anijeje.

«Punojnë dhe natën, ndaj Shqipëria është kaq e bukur», mendoi plaka. Treni shtoi shpejtësinë. Gjergji, nusja, Artani humbën dikë në një kthesë. Atëhere plaka nuk duroi më dhe i la lotët të zbrisnin nga sytë në faqet e fishkura.

\*  
\* \* \*

Në fshat e pritën me këmbët e para. Nusja e Markut qeshte nën buzë, ndërsa plaku turfullonte anës vatrës:

— Na qenka mërzhitur plaka! Nuk i paska duruar dot zhurmat dhe i qenka shpifur malli për fshatin! Pa na paska parë në ëndërr edhe lopën, Larukën.

— Ja pra që u mërzhita, e lëmë ashtu si thua ti. Unë u mërzhita. Shko ti te Gjergji! — mbrohej plaka.

— Kujton ti se nuk shkoj? Kështu të vete mendja? Kjo do të thotë se nuk më paske njohur, megjithëse kemi 40 vjet që jetojmë bashkë. Do të shkoja, nëse nuk do të nevojitesha këtu, në kooperativë. Ja pse rri unë. Kurse ti e ke vendin atje, tek yt bir.

Plaka tundte qumështin në tinjë dhe përgjegjej më të rrallë.

— Nuk i paske duruar zhurmat? Na paske kërkuar edhe policinë që t'i ndalonte, hë? Përse nuk kërkon policin këtu tërë dimrin, kur ortiqet dhe përroi bëjnë zhurmë gjithë natën? E de?



Plaka nuk u përgjegj. Plaku i kishte rënë në të. Vërtet edhe në fshat natën kishte zhurmë, zhurmonte natyra. Si e harroi këtë? Pse iku pra?

Marku i erdhi në ndihmë:

— Pse i bie në qafë, baba? Ajo erdhi, se u mërzit pa ne. Edhe unë do të isha mërzitur në fillim. Ka mall njeriu për shtëpinë. Kështu është gjithnjë në fillim. Pastaj mësohesh... Nëna do të rrijë ca ditë këtu dhe do të niset përsëri. Bën mirë të shkosh edhe ti me të për ca kohë. Ne jemi bijtë tuaj. Keni të drejtë të jetoni te secili prej nesh. — Plaku e shikoi thellë të birin.

— Të shkoj edhe unë thua?

— E pse jo? Tani nuk ke punë deri në pranverë.

Plaka kishte lënë punën dhe vështronte të shoqin gjithë shpresë.



Ata arritën në qytetin buzë detit me trenin e fundit. Ishte natë. Nuk e kishin lajmëruar fare Gjergjin se do të vinin. Ndaj asnjëri nuk doli t'i priste. Rrugën deri në pallat e bënë në këmbë.

Rruga kalonte buzë molos. Pleqtë ecnin ngadalë, të ngarkuar me plaçka. Dritat e prozhektorëve çanin errësirën e qiellit. Zhurmonte lokomotiva, ndërsa dikush thërriste: «Djaaathtaaas, maaaajtaaas, më laaaart, më poooshtë».

Plaku qeshte me shpoti. Plaka nuk fliste.

Trokitën në portë. E hapi Mimoza. Një britmë gëzimi i shpëtoi dhe fytyra i ndriti.

— Gjergji, nëna u kthye me babain.

Gjergji vrapoi në korridor me Artanin në krahë.

— Epo mirë se erdhët! — tha me gaz dhe i përqafoi. Pastaj, për t'i ngacmuar, i foli së shoqes: — Mi-moza, bëj gati dy hape të vogla për pleqtë. I ke aty në dollapin e vogël te shtrati.

Plaka qeshi, por i shoqi serioz u përgjegj:

— Ruaji për vete ato. Tani për tani kam ardhur vetë në vend të hapeve. Do të flemë paq me plakën. Por, më parë, na jepni darkë.

Ranë të flinin vonë, pasi hëngrën darkë dhe biseduan për shumë gjëra me djalin dhe nusen.

Ishte po ajo dhomë, veç u shtua edhe një shtrat portativ, që nusja e vendosi në qoshen tjetër të dhomës. Aty u shtri plaku, të cilin e mori gjumi menjëherë.

Plaka e vështronte të shoqin që nisi të gërhiste. Që prej 40 vjetësh dëgjonte çdo natë atë gërhitje të rëndë, afër veshit të saj. Edhe kjo ishte zhurmë më e rëndë se zhurma e largët e lokomotivës, më e rëndë se britmat e punëtorit me katër fjalët e zakonshme.

Dhe plakën pranë gërhitjes së plakut nisi ta kotte gjumi. Mbylli sytë dhe pëshpëriti fjalët e të birit: «Punojmë dhe natën, ndaj Shqipëria është bërë kaq e bukur».

## PASQYRA E LËNDËS

|                                     | Faqe |
|-------------------------------------|------|
| Një ngjarje e thjeshtë .....        | 3    |
| Kundër rrymës .....                 | 11   |
| I forti .....                       | 16   |
| Në atë dhomë të vogël .....         | 23   |
| Gjethet e dushkut .....             | 29   |
| «Turbulluesi» .....                 | 35   |
| Fijet e holla .....                 | 40   |
| Kandidatja e fundit .....           | 45   |
| Mira .....                          | 54   |
| Njeriu «nën hije» .....             | 61   |
| Provim në korridoret e bardha ..... | 69   |
| Malësori i çuditshëm .....          | 77   |
| Shqetësimet e plakës .....          | 88   |

Redaktore: IRENA DONO

Kopertina nga: SAFO MARKO

Tirazhi 5.000 kopje    Format 70x100/32    Stash: 2284-72

---

Shtyp. Drejtoria Qendrore Poligrafike  
Shtypshkronja «8 NENTORI» — Tiranë, 1973